



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 190 Akti

Nr. 342.Vendimi
Tiranë, më 2.2.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datën 7.1.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Elbana Lluri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin Elbana Lluri, në seancën dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Elbana Lluri është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatës të Apelit Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Elbana Lluri, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.11.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Roland Ilia, Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine (relatore)

3. Menjëherë me hedhjen e shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 14.12.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, bazuar në tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit se afati për të sjellë prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit ishte deri në datë 29.12.2020.

7. Në datën 29.12.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, depozitoi shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, të cilat u administruan dhe analizuan nga trupi gjykues.

8. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 7.1.2021, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

I. SEANCA DËGJIMORE

9. Në datën 7.1.2021, ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, e cila u paraqit personalisht në seancë, dha shpjegimet e saj, si dhe kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar në datën 12.1.2021 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

10. Në datën 11.1.2021, përpara diskutimeve finale të trupit gjykues mbi vendimmarrjen, në media u publikua një denoncim për subjektin e rivlerësimit, pas njohjes me të cilin, trupi gjykues vendosi të shtyjë diskutimet përfundimtare mbi vendimmarrjen dhe shpalljen e vendimit, për të kryer verifikimin e dosjeve gjyqësore të referuara në këtë denoncim, për të vlerësuar nëse kishte në të dhëna për të rihapur hetimi administrativ për subjektin.

11. Pasi nga Komisioni u kryen verifikimet e nevojshme nga të cilat nuk rezultuan *indicie* për rihapjen e hetimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, seanca vijoi në datën 2.2.2021 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

III. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

13. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit (ILDKPKI) ka kryer kontrollin e deklaratës së pasurisë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri dhe në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI-ja bazuar në nenin 33 të ligjit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

A. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017¹, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

15. Pasuria apartament banimi me sip. 125 m², me adresë: rruga "****", k. ***, ap. ***, Tiranë, në bashkëpronësi me z. G. H., sipas kontratës nr. ***, datë 10.10.2012.

15.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar se pjesa takuese e saj prej 50 % është përfitur me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse, pjesa takuese 50 % e z. G. H., paguar nga kredia bankare prej 5.000.000 lekësh, në BKT, sipas VKM-së nr.600, datë 12.9.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë", dhe diferenca prej 1.500.000 lekësh siguruar nga kursimet personale, ndër vite, të tij.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

15.2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri të paluajtshme, si vijon: *"Apartament me sipërfaqe 125 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga "****", k. ***, ap. ***, Tiranë, në bashkëpronësi me z. G. H., pjesa takuese prej 50 % është përfitur me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse. Dhurimi do të*

¹ "41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se "procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse."

pasqyrohet në kontratën përfundimtare të shitjes, e cila do të hartohet në periudhë të mëvonshme”.

15.3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri të paluajtshme, si vijon: “Blerje apartamenti sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 10.10.2012, me sip. 125 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga ****”, k. ***, ap. ***, Tiranë, në bashkëpronësi me z. G. H. në shumën prej 6.500.000 lekësh”. Gjithashtu, deklaroi se pjesa prej 50 % është përfituruar prej saj me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse”.

15.4. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 10.2.2011, është lidhur mes palëve kontrata e premtim-shitjes nr. ***, me objekt premtimin për shitje të apartamentit me sip. 125 m², me adresë: rruga “****”, k. ***, ap. ***, Tiranë, për çmimin prej 6.500.000 lekësh.

15.5. Palët kanë dakordësuar se çmimi do paguhej në dy këste: kësti i parë në shumën 1.500.000 lekë, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate; dhe kësti i dytë në shumën 5.000.000 lekë do të kalonte në favor të shitësit në momentin e lëvrimit të kredisë për z. G. H. nga BKT.

15.6. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në datën 10.10.2012 midis palëve është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, me objekt kalimin e të drejtës së pronësisë mbi apartamentin me sip. 125 m², me adresë: rruga “****”, k. ***, ap. ***, Tiranë, pas lëvrimit të kredisë nga BKT-ja, e cila ka kaluar në favor të palës shitëse, nga llogaria e z.G. H..

16. Lidhur me burimin e krijimit të pjesës së dhuruar prej 50 % të kësaj pasurie

16.1. Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e deklaruës sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, rezultoi të ketë konfirmuar marrëdhënien e dhurimit në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë dorëzuar prej saj në ILDKPKI në vitet 2011 dhe 2012.

16.2. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, ndodhur para një marrëdhënie të konfirmuar të dhurimit, i kërkoi subjektit të rivlerësimit, të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar, pjesës prej 50 % të kësaj pasurie të paluajtshme.

16.3. Subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur dokumentacion lidhur me hapat e fitimit të pronësisë të kësaj pasurie të paluajtshme, nga personi tjetër i lidhur, motra e saj, duke depozituar në cilësinë e provës kontratën e shitjes datë 24.1.2002, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetases A. Ll. me objekt blerjen e të dy apartamenteve me sip. 126 m² dhe sip. 125 m² (ky i fundit apartamenti objekt i hetimit administrativ).

16.4. Subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie prej dhurueses, motrës së saj, janë të ardhurat që familja e saj ka pasur nga dhënia me qira Ambasadës së Republikës së *** në Republikën e Shqipërisë, të pronës së tyre të paluajtshme, ndërtesë 3-katëshe, ndodhur në Tiranë, për periudhën 1994 –2000.

16.5. Lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë të këtyre të ardhurave, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës, dokumentacionin ligjor provues: mandat nr. ***, datë 16.12.1996; mandat nr. ***, datë 7.2.1997; mandat nr. ***, datë 9.4.1997; mandat nr. ***, datë 29.4.1997; mandat nr. ***, datë 6.7.1995; mandat nr. ***, datë 11.11.1994; mandat nr. ***, mandat nr. ***, mandat nr. ***, datë 11.1.1995; mandat nr. ***, mandat nr. ***, datë 14.3.1995; mandat nr. ***, datë 6.7.1995; mandat nr. ***, datë 6.6.1995; mandat nr. ***, datë 11.9.1995; mandat nr. ***, datë 30.10.1995; mandat nr. ***, datë 20.12.1995, mandat nr. ***, datë 26.12.1995; mandat nr. ***, datë 29.5.1997; mandat nr. ***, datë 15.8.1996; mandat nr. ***, datë 11.6.1996; mandat nr. ***, datë 30.12.1996; mandat nr. ***, datë 16.6.1997; mandat nr. ***, datë 9.11.1998; mandat nr. ***, datë 30.12.1998; mandat nr. ***, datë 9.11.1998; mandat nr. ***, datë 18.6.1998; mandat nr. ***,

datë 23.3.1999; mandat nr. ***, datë 29.6.1999, mandat nr. ***, datë 1.10.1999; mandat nr. ***, datë 21.12.1999; mandat nr. ***, datë 27.4.2001 (pagim tatimi për vitin 2000); mandat nr. ***, datë 2.12.2000; mandat nr. ***, datë 17.5.2000; mandat nr. ***, datë 28.12.2000; si dhe vërtetimin e datës 30.5.1997, lëshuar nga Dega e Tatim Taksave Tiranë, ku konfirmohet pagesa e tatimit në shumën 38.670 USD për vitet 1994, 1995 dhe 1996.

16.6. Në analizë të dokumentacionit ligjor provues të mësipërm të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, për sa pagesat e derdhura në llogarinë e organit tatimor nga banka, që në rastin në fjalë, ka vepruar si agjent tatim mbledhës, trupi gjykues ka vlerësuar se detyrimi i subjektit të rivlerësimit, vlerësohet i përmbushur në kuadër të parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

16.7. Nga analiza financiare e kryer mbi bazën e dokumentacionit ligjor provues paraqitur nga subjekti (mandatet e pagimit të tatimeve), të ardhurat *neto* nga dhënia me qira e e pronës së tyre të paluajtshme, ndërtesë 3-katëshe, ndodhur në Tiranë, për periudhën 1994 –2000, për të cilën është paguar tatimi, rezultojnë të jenë në vlerën rreth 52 milion lekë.

16.8. Në drejtim të vlerësimit të mundësisë financiare të dhurueses (motrës te subjektit), trupi gjykues vlerëson se te ardhurat familjare kanë qenë të mjaftueshme për të mundësuar investimin në blerjen e kësaj banese, dhe se vlera e blerjes së kësaj pasurie konsideruar hipotetike, konstatohet se është e pakonsiderueshme në drejtim të të ardhurave të përfituara nga familja e dhurueses, të përdorura si burim i financimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

16.9. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se për sa i përket pjesës takuese prej 50% të kësaj banese, pronësia e të cilës u përfitua me dhurim, subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion ligjor provues mënyrën se si personi tjetër i lidhur, motra e subjektit, fitoi pronësinë mbi atë apartament si dhe të ardhurat e përdorura për krijimin e kësaj pasurie, duke provuar se për to ishin paguar detyrimet tatimore, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me burimin e krijimit të shumës 1.500.000 lekë, kursime të z. G. H.

17.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer shuma 1.500.000 lekë nga kursimet personale, ndër vite, të z. G. H..

17.2. Për të vlerësuar lidhur me mundësinë e krijimit të kursimeve në shumën 1.500.000 lekë nga z. G. H., u analizuan deklaratimet vjetore periodike vjetore të tij, ku ai ka deklaruar si vijon:

- DPV-në e vitit 2005, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar më shumën 350.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2006, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar me shumën 350.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2007, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar në shumën 100.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2008, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar në shumën 200.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2009, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar në shumën 400.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2010, z. G. H., deklaruar: *gjendje cash shtuar në shumën 350.000 lekë;*
- DPV-në e vitit 2011, z. G. H., deklaruar: *pakësuar gjendja cash në shumën 1.500.000 lekë për blerje apartamenti, krijuar nga kursimet personale ndër vite.*

17.3. Trupi gjykues, pasi analizoi mundësinë financiare të z. G. H. për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar nga viti 2005 – 2011, vlerëson se z. G. H. ka pasur mundësi financiare për të krijuar në vitet 2005 – 2011, gjenden *cash* të deklaruar në vlerën prej 1.500.000 lekësh.

18. Lidhur me burimin e krijimit kredi me kushte lehtësuese në vlerën 5.000.000 lekë.

18.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer edhe kredia bankare prej 5.000.000 lekësh, marrë nga z. G. H., në Bankën Kombëtare Tregtare (në vijim BKT), në zbatim të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”.

18.2. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në datën 9.6.2011 mes kredihënësit BKT dhe kredimarrësit G. H. është lidhur kontrata e kredisë bankare me kushte lehtësuese. Subjekti i rivlerësimit ka qenë dorëzanëse në këtë kredi.

18.3. Në datën 15.6.2011, është *disbursuar* në llogarinë bankare të z. G. H. kredia 5.000.000 lekë, dhe brenda të njëjtës ditë nga kjo llogari u transferua shuma 4.900.000 lekë në favor të Ç., me përshkrim: “G. H. paguan A. Ç. për blerje apartamenti”.

18.4. Nga hetimi gjithashtu ka rezultuar, se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka marrë një hua në “Emporiki Bank” në vitin 2009, në shumën 25.000 euro, me objekt arredim apartamenti, kredi në të cilën dorëzanës ka qenë z. G. H..

18.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa kredia në “Emporiki Bank”, ngrinte dyshime mbi të drejtat reale mbi këtë apartament dhe kohën e përfitimit të tyre, para marrjes së kredisë me kushte lehtësuese, rrethana që duket se çonin në situatën e përfitimit të padrejtë të kredisë me kushte lehtësuese, konkluzion mbështetur edhe referuar gjendjes *cash* në kohën e përfitimit të kësaj kredie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

18.6. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, mbi të drejtat reale mbi këtë apartament para marrjes së kredisë së butë, subjekti ka shpjeguar se të drejtat reale të pasurisë apartament janë krijuar në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes së këtij apartamenti.

18.6.1. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, mbi gjendjen *cash* të disponuar në kohën e përfitimit të kësaj kredie, subjekti ka shpjeguar se fakti i gjendjes *cash* në një vlerë të caktuar, nuk përbënte ndalesë për aplikim të kredisë së butë, pasi kjo e drejtë bazohej në qenien subjekt (gjyqtar) i pastrehë, pa një pasuri të paluajtshme në pronësi, kusht i cili është përmbushur.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

18.7. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit, nuk janë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në kohën e përfitimit të kësaj kredie me kushte lehtësuese për sa më poshtë vijon.

18.8. Bazuar në VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007 gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, subjekteve u lindte nevoja për strehim apo sipërfaqe banimi shtesë, duke u lindur e drejta të kërkonin trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti për blerje banese apo sipërfaqe banimi shtesë në vendin e ushtrimit të detyrës.

18.9. Në kuptim të këtij vendimi, në kohën e marrjes së kredisë, pasja në pronësi të tyre e pasurive përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim, përbënte kusht skualifikues për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese sipas germës “ç”, të pikës 6, të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007.

18.9.1. Në analizën e dosjes së kreditimit nga NBG, rezulton që kjo bankë i ka dhënë kredi subjektit të rivlerësimit për një pasuri të paluajtshme, i cili në momentin e kreditimit ishte në pronësi të hipotekuesve të pasurisë, motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj.

18.9.2. Referuar legjislacionit bankar e drejta për të aplikuar për një kredi për rregullimin e një pasurie të paluajtshme i takon pronarit apo atij që provon se ka të drejta reale mbi këtë apartament.

18.9.3. Ky status i mbajtësve të të drejtave reale të kësaj pasurie të paluajtshme është konfirmuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.2.2009, depozituar në dosjen e kredisë për mobilim, ku motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj, si pronarë të apartamentit, kanë deklaruar se *marrin përsipër që këtë pronë do ta kalojnë brenda afatit njëvjeçar në pronësi të shtetasve, Elbana Lluri dhe G. H.*, me anë të një veprimi të mëvonshëm për kalim pronësie. Nuk rezulton në dosjen e kredisë, asnjë dokumentacion ligjor me të cilin deklaruesit të kenë ndryshuar deklarinimin e mësipërm, për këtë pasuri.

18.9.4. Trupi gjykues vlerëson se ishin pikërisht të drejtat reale të këtij apartamenti fituar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri dhe z. G. H., me anë të deklaratës noteriale të sipërcituar të pronarëve të tij, ato që mundësuan përfitimin e kredisë për mobilim në NBG.

18.9.5. Trupi gjykues vlerëson se dhe gjendja *cash* në kohën e përfitimit të kësaj kredie me kushte lehtësuese nga subjekti e personi i lidhur me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim, përbënte kusht skualifikues për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese.

18.10. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me marrëdhënien e kreditimit, në BKT, në zbatim të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, vlerësoi se duhet të shprehet dhe analizojë vetëm përgjegjësinë konkrete të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, si dorëzanëse në këtë kredi të përfituar nga z. G. H..

18.11. Sipas parashikimeve të neneve 585 e vijues të Kodit Civil, të cilat rregullojnë dorëzaninë, dorëzanësja, në këtë rast, znj. Elbana Lluri, detyrohej t’i siguronte kreditorit, në këtë rast, Bankës Kombëtare Tregtare, vetëm ekzekutimin e detyrimit të debitorit kryesor, z. G. H., por ajo nuk mund të ngarkohej me përgjegjësi lidhur me plotësimin e kushteve për përfitimin e kësaj kredie prej kredimarrësit.

18.12. Mëvetësia e marrëdhënies së dorëzansë si *një veprim juridik* i lidhur ndërmjet dorëzansit dhe kreditorit ka formën, kushtet dhe efektet për të realizuar qëllimin e saj.

18.13. Dorëzanësi është subjekt i ndryshëm nga debitori dhe përgjegjësia ligjore është e kufizuar vetëm për të siguruar përmbushjen e detyrimit, të përcaktuar nga debitori, për të cilin është krijuar dorëzania, brenda një afati prekluziv, mosrespektimi i të cilit ka si pasojë shuarjen e së drejtës së kreditorit për të realizuar të drejtën e tij nëpërmjet pasurisë së dorëzansit.

18.14. Trupi gjykues vlerëson se palët, kreditor dhe debitor, janë subjektet e marrëdhënies juridike që lind gjatë procesit të kreditimit dhe i rëndësishëm është *mosndryshimi i identitetit të tyre*.

18.15. Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkaqe ligjore për të ngarkuar me përgjegjësi ligjore subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, lidhur me rrethanat mbi përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese, aplikimit, deklarinimit mbi plotësimin e kushteve dhe ligjshmërisë së përfitimit të saj.

18.16. Rrethanat lidhur me ligjshmërinë e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese dhe përmbushjen e parashikimeve ligjore të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, lidhen ekskluzivisht me kredimarrësin, për rrjedhojë, me z. G. H. dhe ato në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm, analizohen nga trupi gjykues i shortuar për çështjen e tij.

18.17. Ky vendim i trupit gjykues, në asnjë rast, nuk paragjykon të drejtën për një hetim të pavarur të paanshëm dhe një rivlerësim të tij në përputhje provat që i përkasin çështjes së tij.

19. Pasuria automjetin “Citroen C4”.

19.1. Nga hetimi² rezultoi se në datën 16.8.2012 midis shoqërisë “****”, subjektit dhe bashkëshortit është lidhur kontrata e qirasë financiare (*leasing*) me objekt dhënien me qira financiare të automjetit tip “Citroen C4” me targa ***.

19.2. Sipas kësaj kontrate çmimi është përcaktuar në shumën 16.500 euro, ku qiraja e parë 54.5 % të vlerës përfundimtare është paguar, në datën 16.8.2012, ndërsa qiratë në vijim do të paguheshin në bazë mujore, duke filluar nga datë 10.9.2012, në datën 10 të çdo muaji në “****”, pranë “Tirana Bank”.

19.3. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2012, vit kur janë kryer pagesat për automjetin “Citroen C4” ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare të investojnë në pasurinë automjet tip “Citroen C4”, në ditën e blerjes dhe të kryejnë shpenzimet e tjera gjatë këtij viti, duke rezultuar me balancë negative në shumën - 1.135.318 lekë për vitin 2012.

19.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për rezultatin financiar negativ ditën e blerjes dhe për vitin 2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

19.5. Subjekti ka shpjeguar se: *“Mos deklarimi si shtesë e gjendjes cash për vitin 2011 nga ana e personit të lidhur e shumës 1.200.000 lekë, është një pasaktësi në plotësimin e deklaratës periodike vjetore nga ana e ish-bashkëshortit, sepse ky shtetas është mjaftuar me faktin që të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit janë marrë cash prej tij”.*

19.6. Subjekti ka kërkuar edhe rishikimin e udhëtimeve të përbashkëta të kryera gjatë kësaj periudhe me familjarët e saj, duke kërkuar për sa i përket shpenzimeve të qëndrimit të udhëtimeve që janë mbuluar nga motra (bashkudhëtarë në këto udhëtime), të llogariten nga Komisioni, si janë deklaruar prej saj në pyetësin standard.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

19.7. Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2011, Komisioni administroi dhe analizoi deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 të personit të lidhur, z. G. H., ku nuk rezultoi që shuma prej 1.200.000 lekësh të jetë deklaruar si shtesë e gjendjes *cash* për vitin 2011 nga personi i lidhur.

19.8. Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2011 vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, për të provuar deklaratimet e subjektit.

19.9. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi gjendjen *cash* për vitin 2011 nga personi i lidhur, z. G. H., është i pambështetur në prova dhe në ligj.

19.10. Lidhur me pretendimin e subjektit në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për një pjesë të udhëtimeve jashtë Republikës së Shqipërisë, dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në formën e deklaratës noteriale nga motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj, u trajtua nga trupi gjykues në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

² Në dosjen e ILDKPKI-së aneksi ***.

19.11. Vlera provuese e kësaj deklarate u vlerësua nga trupi gjykues në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimit të dhënë në të, provave të tjera, si dhe të dhënave apo informacioneve të administruara gjatë hetimit administrativ.

19.12. Në deklarimin e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit prej motrës së subjektit, në rastet e disa udhëtimeve të përbashkëta, kryer prej tyre trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe sa vijon:

- marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me motrën e saj, si marrëdhënie familjare e vazhdueshme pasqyruar në ndihmën e vazhdueshme që subjekti ka pasur, ndër vite, nga motra;
- faktin që subjekti nuk gjendet në kushtet e një trajtimi preferencial, i cili duhej të deklarohet para organit kompetent ILDKPKI-së, mbi këto pagesa të cilat nuk kalonin as pragun e deklarimit;
- nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, është provuar mundësia financiare e motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të mbuluar këto shpenzime gjate udhëtimeve të përbashkëta;
- nga verifikimi në sistemin *TIMS* ka rezultuar se këto udhëtime janë kryer bashkërisht nga familja e subjektit me familjen e motrës së saj, dhe deklarohen nga subjekti që në pyetësin standard.

19.13. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, si dhe vlerësoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për mbulimin e kostove të qëndrimit në udhëtimet e përbashkëta disa-ditore prej motrës duhet të pranohet dhe, për rrjedhojë, duhen zbritur këto kosto qëndrimesh për udhëtimet në analizën finale financiare në vitin 2012, në vlerën 260.562 lekë.

19.14. Në lidhje me udhëtimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, deklaruar si udhëtime pune, trupi gjykues, administroi dhe analizoi para vendimmarrjes dokumentacionin e paraqitur nga bashkëshorti i subjektit, z. G. H., për këto udhëtime pune ku vërtetohej përballimi me shpenzime të buxhetit të shtetit ose me financim nga organizatorët e aktiviteteve përkatëse.

19.15. Trupi gjykues vlerësoi se në analizën finale financiare në vitin 2012, duhet zbritur vlera prej 183.033 lekësh, si kosto e udhëtimeve të bashkëshortit, provuar se ka qenë përballuar me shpenzime të buxhetit të shtetit ose me financim nga organizatorët e aktiviteteve përkatëse.

19.16. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se në përfundim të analizës financiare të kryer për vitin 2012, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuarra së bashku, duke reflektuar në analizën financiare vetëm mbi shpenzimet e udhëtimeve, arriti në përfundimin se me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për vitin 2012, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe kryerjen e pagesave për automjetin dhe shpenzime të tjera, duke rezultuar me bilanc negativ total për vitin 2012 në vlerën -691.723 lekë.

20. Pasuria apartament banimi me nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë, në bashkëpronësi me bashkëshortin në vlerën 55.452 euro. Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: *“Kursimet e mia dhe të bashkëshortit, të realizuara gjatë gjithë jetës tonë, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë për efekt të ligjit nr. 84/2016”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

20.1. Subjekti e deklaroi këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me burim krijimi të njëjtë me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

20.2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti deklaroi pakësimin e gjendjes *cash* të përdorur për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, duke deklaruar se pas blerjes së kësaj pasurie gjendja *cash* e mbetur në banesë në vitin 2016 ishte në vlerën 500.000 lekë.

20.3. Në datën 17.9.2016 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, midis palës shitëse A. dhe A. Ç. dhe palës blerëse Elbana Lluri dhe G. H., çmimi i blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme është përcaktuar në vlerën 55.452 euro.

20.4. Likuidimi i çmimit është realizuar nga pala blerëse nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të noterës I. B. pranë BKT-së, në datën 9.9.2016 të shumës, e cila është transferuar nga noterja të pala shitëse.

20.5. Kjo pasuri është regjistruar në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të shtetasve Elbana Lluri dhe G. H. nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 17.9.2016.

20.6. Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me shpenzimet e arredimit, e cila ka shpjeguar se: *“Nuk kemi bërë asnjë shpenzim për mobilim, pasi ky apartament ka qenë i mobiluar dhe i gatshëm për shfrytëzim nga shitësit e mëparshëm”*. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime për arsyet e mosparashikimit në çmimin e shitjes së kostove të mobilimit, e cila ka shpjeguar se apartamenti ka qenë i mobiluar nga shitësja, motra e saj.

20.7. Trupi gjykues, pasi analizoi çmimin e blerjes së kësaj pasurie të paluajtshme, i cili ishte i përafërt me çmimin me të cilin pala shitëse e kishte blerë këtë pasuri në datën 31.3.2014, dhe vlerat e shitjes së banesave sipas EKB-së, nuk konstatoi problematika mbi çmimin e shitblerjes.

20.8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 ka deklaruar se si burim për investimin e kryer në pasurinë e paluajtshme, apartament i ndodhur në Vlorë ka përdorur kursimet e saj dhe të bashkëshortit të realizuara gjatë gjithë jetës së tyre sipas përshkrimit të bërë në deklaratat e tyre të pasurisë.

20.9. Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me burimet konkrete që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit. Subjekti, në përgjigjet e saj, ka deklaruar se: *“Shuma prej 55.452 eurosh e përdorur nga ana ime dhe e ish-bashkëshortit tim për blerjen e këtij apartamenti, përbën kursimet e mia dhe të ish-bashkëshortit që nga viti 2004 kur edhe kam kryer deklarimin fillestar të kursimeve që kam disponuar përpara fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e deri në vitin 2016, kur edhe është realizuar kjo blerje”*.

20.10. Trupi gjykues analizoi gjendjen *cash* të deklaruar, ndër vite, nga të dy bashkëshortët, që është përdorur si burim krijimi për këtë pasuri të paluajtshme nga ku rezultoi si vijon.

20.11. Në deklarimin periodik të vitit 2004, njëkohësisht dhe deklarata për herë të parë e subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar se ka disponuar *cash* shumën 5.000.000 lekë.

20.12. Në deklaratat periodike vijuese subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar:

- Në DPV-në e vitit 2005, nuk deklaroi shtesë / pakësim *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2006, deklaroi kursime nga paga në shumën 450,000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2007, deklaroi kursime nga paga në shumën 150,000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2008, deklaroi kursime nga paga 200,000 në shumën lekë;
- Në DPV-në e vitit 2009, nuk deklaroi shtesë/pakësim *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2010, deklaroi kursime në shumën 200,000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2011, deklaroi kursime në shumën 200,000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2012, nuk deklaroi shtesë / pakësim *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2013, nuk deklaroi shtesë / pakësim *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2014, deklaroi *cash* shumën 300,000 lekë (me bashkëshortin).

20.13. Në deklarimin periodik të vitit 2003, njëkohësisht dhe deklarata për herë të parë e subjektit të rivlerësimit, z. G. H., ka deklaruar se ka disponuar *cash* shumën prej 2.500.000 lekësh.

20.14. Në deklaratat periodike vijuese subjekti i rivlerësimit, z. G. H., ka deklaruar si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2004 gjendje *cash* e mbetur në shumën 1.500.000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2005, ka deklaruar gjendje *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2012, nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2013, nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- Në DPV-në e vitit 2014, deklararon *cash* shumën 300,000 lekë (me bashkëshorten);
- Në DPV-në e vitit 2015, deklararon pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 800.000 lekë.

i) Lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash* të z. G. H.

20.15. Për sa i përket gjendjes *cash* të deklaruar nga z. G. H. në vitet 2005 – 2011, trupi gjykues vlerëson se kjo gjendje *cash*, nuk ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, për sa ka shërbyer si burim krijimi për pagimin e këstit të parë të kontratës së premtim shitjes nr. ***, të apartamentit me sip. 125 m², ndodhur në Tiranë, pagesë e vitit 2011, në vlerën 1.500.000 lekë.

20.16. Për të ardhura *cash* të deklaruara në deklarinimin periodik të viteve 2003 – 2004, nga bashkëshorti i subjektit, njëkohësisht subjekt rivlerësimi, z. G. H., nuk provohet me dokumentacion ligjor provues pagesat e detyrimeve tatimore në kohën e përfitimit të tyre.

ii) Lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash* të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri

20.17. Në deklarinimin periodik të vitit 2004, njëkohësisht dhe deklarata për herë të parë e subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar se ka disponuar *cash* shumën prej 5.000.000 lekësh.

20.18. Kjo shumë e deklaruar në deklaratën e vitit 2004, si kursime të familjes nga dhurimet nga motra, është detajuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si vijon: nga pagesat mujore kryer nga familjarët në shumën 35.000 lekë/muaj për periudhën 1997 – 2004; nga shuma prej 2.000.000 lekësh përfituar nga dhurimi nga motra në vitin 2004 për diplomimin në Shkollën e Magjistraturës; nga pagesa e bursës së akorduar nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2002 – 2004; nga paga e përfituar për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2004, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; nga pagesa e përfituar nga janari i vitit 2004 si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë pranë Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “****”; si dhe të ardhurat nga bursa e ekselencës për rezultatet maksimale në Fakultetin e Drejtësisë.

20.19. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bursa e ekselencës në Fakultetin e Drejtësisë për vitet 1999 – 2002, në shumën 225.000 lekë, për shkak të rezultateve maksimale në shkollimin e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

20.19.1. Pavarësisht se Komisioni hetoi për rezultatet e shkollimit të cilat u konfirmuan nga hetimi administrativ, duke provuar të ardhurat e bursës së ekselencës, trupi gjykues për sa kohe që subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar se këto të ardhura janë përdorur për përballimin e shpenzimeve të saj, nuk i ka përfshirë të ardhurat në shumën 225.000 lekë si burim krijimi për shumën 5.000.000 lekë, gjendje *cash*.

20.20. Lidhur me të ardhurat në formë burse të përfituara nga Shkolla e Magjistraturës në shumën totale 772,790 lekë për vitet 2002 – 2004, për të cilat subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimit nr. ***, datë 14.10.2016, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, me të cilin vërtetohet se është paguar në formë burse në cilësinë e kandidatës për magjistrate për periudhën 2002 – 2004, në total në shumën 772.790 lekë.

20.20.1. Referuar dokumentacionit ligjor provues këto të ardhura të provuara me vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës janë konsideruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

20.21. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga paga si pedagogë e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë pranë Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “***”, për 11 muaj nga 25.000 lekë/muaj, nga janari i vitit 2004 në shumën totale 275,000 lekë gjatë ushtrimit të detyrës, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimit datë 26.10.2016.

20.21.1. Komisioni verifikoi, gjithashtu, edhe deklarin e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën subjekti ka deklaruar këto të ardhura në formën e pagës mujore 25.000 lekë/muaj. Referuar analizimit të dokumentacionit ligjor provues këto të ardhura të provuara janë konsideruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

20.22. Lidhur me të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për muajt tetor, nëntor dhjetor 2004, subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të ardhurat *neto* nga paga për këtë periudhë në shumën 192.453 lekë.

20.22.1. Komisioni verifikoi deklarin e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën subjekti ka deklaruar këto të ardhura. Referuar dokumentacionit ligjor këto të ardhura të provuara janë konsideruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni

20.23. Lidhur me të ardhurat në shumën 2.000.000 lekë dhuruar nga motra.

20.23.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, lidhur me këtë shumë, ka deklaruar: [...] “*të ardhura të dhuruara nga motra ime znj. A. Ll. Ç., për shkak të mbarimit të shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë kësaj kohe shpenzimet e mia përballoheshin nga të ardhurat nga bursa si studente e shkëlqyer nga fakulteti i drejtësisë, prindërit, me të cilët banonte dhe motra, znj. A. Ll. (Ç.)*” [...].

20.23.2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, njëkohësisht dhe deklarimi për herë të parë i subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka deklaruar: “*Të holla cash të ruajtura në banesë kursime familjare, dhuratë nga motra ime në shumën 5.000.000 lekë*”.

20.23.3. Komisioni, përveç verifikimit të deklarin të këtij dhurimi në vitin 2004 nga subjekti i rivlerësimit, ka verifikuar burimin e ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme dhuruar nga personit tjetër i lidhur, motra e subjektit analizuar më lart në këtë vendim, duke u provuar të ardhurat e ligjshme për të cilat është paguar tatim, ka konsideruar të provuar mundësinë e tyre financiare për të krijuar këto të ardhura të dhuruara, sipas analizës financiare të kryer për ta, për të mundësuar kryerjen e dhurimit të shumës së deklaruar nga subjekti.

20.23.4. Referuar parashikimeve ligjore në fuqi në kohën e dhurimit nuk ka pasur ndonjë parashikim ligjor për tatimin e pagimit për tatimin mbi dhurimet.

20.23.5. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shpresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se bazuar në rrethanat e faktit dhe ligjit, lidhur me dhurimin e kryer nga motra në vlerën 2.000.000 lekë: (i) duke iu referuar deklarinimeve të subjektit në DPV-në e vitit 2004; (ii) duke iu referuar mundësisë financiare të dhuruesve për të krijuar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; (iii) duke iu referuar faktit që këto të ardhura janë përfitur dhe deklaruar nga subjekti para se të emërohej në detyrë, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë përfitim dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave të dhuruara nga motra e saj.

20.24. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara nga motra e saj për periudhën 1997 – 2004, në deklaratën *Vetting*, subjekti e deklaroi këtë shumë me përshkrimin: “*Nga pagesat mujore nga familjarët në shumën 35.000 lekë/muaj për periudhën 1997 – 2004*”.

20.24.1. Për këto të ardhura të deklaruara nga subjekti si të ardhura nga motra, trupi gjykues ka vlerësuar se është e paqartë forma ligjore e përfitimit të tyre dhe nëse këto të ardhura ishin të

ardhura nga puna për to duhet provuar me dokumentacion ligjor provues pagesa e detyrimit tatimor në kohën e përfitimit të tyre.

21. Pasuria automjet tip “Toyota”, me targa *, në bashkëpronësi me bashkëshortin G. H., blerë nga shtetasi A. Ç., sipas kontratës për shitje automjeti nr. ***, datë 29.12.2016. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.**

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

21.1. Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti deklaron: *“Pakësim të ardhurash për blerje automjetit tip ‘Toyota’, me targa ***, blerë nga shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip Citroen C4 me targa ***”.*

21.2. Nga hetimi rezultoi se në datën 29.12.2016, midis shitësit A. Ç. dhe blerësve G. H. dhe Elbana Lluri u lidh kontrata me objekt shitjen e automjetit “Toyota RAV4”, për çmimin e shitjes 5.000 euro.

21.3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor konfirmoi regjistrimin në emër të subjektit dhe ish-bashkëshortit. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se çmimi i blerjes në datën 16.10.2009, nga shitësi ishte në vlerën 16.000 USD.

21.4. Subjekti, në përgjigje të pyetorit të dytë, ka shpjeguar arsyet e blerjes së këtij automjeti në çmim më të ulët se çmimi i blerjes nga pala shitëse duke shpjeguar se: *“Shuma e shitjes së këtij automjeti sipas deklarimeve të dhëna nga pala shitëse, është më e ulët se sa vlera e blerjes së tij, për shkak të amortizimit të mjetit gjatë periudhës së përdorur nga z. A. Ç., gjendjes së tij në momentin e shitjes dhe marrëdhëniet të afërta në krushqi mes meje dhe pronarit të mjetit (z. A. Ç. është bashkëshorti i motrës sime znj. A. Ll. (Ç.)”.*

21.5. Komisioni verifikoi në sistemin TIMS udhëtimet dhe të dhënat e AMF-së në lidhje me automjetin “Toyota” nga ku nuk rezultuan problematika lidhur me përdorimin e këtij automjeti.

21.6. Gjithashtu, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se automjeti është shitur pas 7 vjetësh përdorimi nga pala shitëse, amortizimin e mjetit gjatë kësaj kohe, dhe faktin se subjekti dhe pala shitëse janë motra, nuk konstatoi problematika lidhur me çmimin e shitjes të këtij automjeti.

21.7. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2016, kur janë pagesat për automjetin automjetit tip “Toyota” dhe investimin në pasurinë e paluajtshme apartament, ndodhur në Vlorë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e bashkëshorti nuk kane pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe kryerjen e shpenzime të tjera, duke rezultuar me balancë negative në vitin 2016 në shumën -663.011 lekë.

21.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa më poshtë duket se:

i) ngelet e paqartë forma ligjore e përfitimit të të ardhurave nga motra e subjektit për periudhën 1997 – 2004, dhe nëse këto të ardhura ishin të ardhura nga punësimi i subjektit te motra e saj, nuk provohet me dokumentacion ligjor provues pagesa e detyrimeve tatimore në kohën e përfitimit;

ii) nuk provohen me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti deklaruar ne DPV 2003-2004, dhe nuk provohet me dokumentacion ligjor provues pagimi i detyrimit tatimor në kohën e përfitimit të tyre;

iii) nuk duket se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga shitja e automjetit “Citroen C4”, në vitin 2011, të kenë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, për sa nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në deklarin periodik vjetor të vitit 2011;

iv) ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e bashkëshorti nuk kane pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe kryerjen e shpenzime të tjera, duke rezultuar me balancë negative në vitin 2016 në shumën -663.011 lekësh.

22. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ka kërkuar marrjen në konsideratë në analizën financiare nga Komisioni të sa vijon:

22.1. Gjendjes së kursimeve *cash* në shumën 100.000 lekë në vitin 2005, deklaruar prej saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, duke paraqitur si provë një kopje të kësaj deklarate.

22.2. Kohës së kryerjes së këmbimit të shumës së përdorur për burim krijimi, nga lekë në monedhë euro në fillim të vitit 2009, duke pretenduar konvertimin e kësaj shume në këtë periudhë.

22.3. Të ardhurat e përfituara nga motra e saj për periudhën 1997 – 2004, *për sa kohë që ndodhej përpara një marrëdhënieje familjare dhe ndihme të dhënë nga personi i lidhur.*

22.4. Subjekti, lidhur me të ardhurat *cash* deklaruar nga ish-bashkëshorti ne vitet 2003-2004, ka kërkuar të merret në konsideratë se ajo nuk ka mundësi reale për të marrë informacione në lidhje me të ardhurat e realizuara para fillimit të detyrës prej tij, dhe se këto të ardhura nuk kanë shërbyer për blerjen e ndonjë pasurie.

22.5. Subjekti ka kërkuar, gjithashtu, rishikimin e udhëtimeve të kryera gjatë kësaj periudhe, duke kërkuar se për sa i përket shpenzimeve të mbuluara nga motra dhe bashkëshorti, gjatë udhëtimeve të përbashkëta të kryera prej tyre, sikundër i ka deklaruar në pyetësorin standard.

23. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

23.1. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi gjendjen *cash* në vitin 2005, trupi gjykues, pasi analizoi provën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se deklarata periodike e vitit 2005 e depozituar nga subjekti në cilësinë e provës është një akt i fotokopjuar, përmban vetëm firmën e subjektit dhe nuk ka ekstremitetet e duhura të një akti zyrtar (vulë, protokoll institucioni).

23.1.1. Deklaratat periodike vjetore të administruara gjatë hetimit të Komisionit nga ILDKPKI-ja, janë të vetmet prova në këtë proces për të rrëzuar apo pranuar pretendimet e subjektit.

23.1.2. Referuar deklaratës së vitit 2005, përcjellë nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar kursime gjendje *cash* në vitin 2005, prandaj, për rrjedhojë, kjo gjendje *cash* nuk mund të merret në konsideratë në këtë vit kalendarik në analizën financiare.

23.2. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi këmbimin e vlerave monetare në kohë, trupi gjykues, pasi analizoi deklarin vjetor periodik të subjektit në vitin 2009, vëren se në këtë deklarin nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti këmbimi valutor i shumës nga lekë në monedhën euro. Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, ky deklarin përbën provë për të mbështetur apo rrëzuar pretendimin e subjektit, lidhur me sa më sipër.

23.2.1. Trupi gjykues vlerëson se ky veprim, pretenduar nga subjekti, vlerësohet vetëm përmes deklarin të saj në deklaratën periodike, që në rastin konkret për shkëmbimin e vlerave monetare mungon.

23.2.2. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky pretendim i subjektit nuk mund të merret në konsideratë, për sa nuk gjen mbështetje nga deklarin periodik vjetor i vitit 2009 i subjektit.

23.3. Lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2011, trupi gjykues, pasi analizoi deklarimin periodik të z. G. H. në vitin 2011, konstatoi se shuma 1.200.000 lekë nuk rezultoi të jetë deklaruar si shtesë e gjendjes *cash* në fund të vitit 2011 prej tij.

23.3.1. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për këtë gjendje *cash* të disponueshme në vitin 2011, është i pambështetur në prova, pasi në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, ky deklaram periodik vjetor i vitit 2011, përbën provë për të mos mbështetur pretendimin e subjektit mbi këtë gjendje *cash*.

23.4. Lidhur me të ardhurat e përfituara prej motrës për periudhën 1997 – 2004

23.4.1. Në lidhje me të ardhurat e siguruar nga motra e subjektit, trupi gjykues ka vlerësuar shpjegimet e dhëna nga subjekti, në të cilat ka pretenduar se nuk ka qenë në marrëdhënie punësimi me motrën por ka qenë ndihmë e dhënë nga personi i lidhur, motra e saj, ka vlerësuar sa vijon:

a) këto të ardhura janë deklaruar në vitin 2004 si dhurim nga subjekti i rivlerësimit. Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, ky deklaram përbën provë për të mbështetur apo rrëzuar pretendimin e subjektit, lidhur me sa më sipër.

b) gjatë hetimit administrativ u provua ekzistenca e të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme të dhurueses, motrës së subjektit për shumat e dhuruara në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;

c) shpjegimet e subjektit, pas kalimit të barrës së provës dhe në seancën dëgjimore, ishin bindëse, për sa i përket marrëdhënies së dhurimit dhe faktit se nuk bëhej fjalë për të ardhura nga punësimi.

ç) në hetim nuk rezultoi asnjë fakt që të vërë në dyshim dhurimin e kryer nga motra për subjektin në vitet para fillimit të detyrës prej saj, përkundrazi, rezultuan prova të tjera që mbështesnin këtë.

23.4.2. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se bazuar në këto rrethana fakti dhe ligji, lidhur me të ardhurat e përfituara nga motra e saj, në shumën 35.000 lekë/muaj për periudhën 1997 – 2004, duke mbajtur në konsideratë se: (i) deklaramet e subjektit në DPV-në e vitit 2004; (ii) mundësinë financiare të dhuruesve për të krijuar të ardhurat e dhuruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; (iii) këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti para se të emërohej në detyrë, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë përfitimin dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

23.5. Lidhur me deklaramet e gjendjes *cash* të z. G. H.

23.5.1. Për sa i përket ligjshmërisë së gjendjes *cash* të z. G. H., deklaruar në vitet 2003 – 2004, trupi gjykues vlerëson së pari se pretendimi i subjektit se këto të ardhura nuk kanë shërbyer për blerjen e ndonjë pasurie nuk është i mbështetur në prova për sa kohë vetë subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për apartamentin në Vlorë, kanë qenë *kursimet e saj dhe të bashkëshortit, të realizuara gjatë gjithë jetës së tyre*.

23.5.2. Trupi gjykues, pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e gjendjes *cash* të deklaruar nga z. G. H. në vitet 2003 – 2004 e ka, ky subjekt rivlerësimi, në gjykim nga një trup tjetër, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm.

23.5.3. Ky konkluzion i trupit gjykues mban në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit është njohur me ish-bashkëshortin disa vite më vonë se periudha kur është krijuar ky likuiditet.

23.6. Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve

23.6.1. Lidhur me pretendimin e subjektit në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për një pjesë të udhëtimeve jashtë Republikës së Shqipërisë, dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në formën e deklaratës noteriale nga motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj, u trajtua nga trupi gjykues në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të gërmës "c", të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

23.6.2. Vlera provuese e kësaj deklarate u vlerësua nga trupi gjykues në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratës të dhënë në të, provave të tjera, si dhe të dhënave apo informacioneve të administruara gjatë hetimit administrativ.

23.6.3. Në deklarin e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit prej motrës së subjektit, në rastet e disa udhëtimeve të përbashkëta, kryer prej tyre trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe:

- marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me motrën e saj, marrëdhënie familjare e vazhdueshme e pasqyruar në ndihmën e vazhdueshme që subjekti ka pasur, ndër vite, nga motra e saj;

- faktin që subjekti nuk gjendet në kushtet e një trajtimi preferencial, i cili duhej të deklarohet para organit kompetent ILDKPKI-së, mbi këto pagesa të cilat nuk kalonin as pragun e deklaratës;

- faktin që nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, u provua mundësia financiare e motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të mbuluar këto shpenzime të udhëtimeve të përbashkëta;

- faktin që nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezultoi se këto udhëtime janë kryer bashkërisht nga familja e subjektit me familjen e motrës, dhe u deklaruan nga subjekti në pyetësorin standard.

23.6.4. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerësoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për mbulimin e kostove të qëndrimit në udhëtimet e përbashkëta disa-ditore prej motrës duhet të pranohet dhe, për rrjedhojë, duhen zbritur këto kosto qëndrimesh për udhëtimet në analizën finale financiare në vitin 2016, në vlerën 207.639 lekë.

23.6.5. Në lidhje me udhëtimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, deklaruar si udhëtime pune, trupi gjykues, administroi dhe analizoi para vendimmarrjes edhe dokumentacionin e paraqitur nga bashkëshorti i subjektit, z. G. H., për këto udhëtime pune ku vërtetohej përballimi me shpenzime të buxhetit të shtetit ose me financim nga organizatorët e aktiviteteve përkatëse.

Trupi gjykues vlerësoi se për rrjedhojë, duhen zbritur në analizën finale financiare në vitin 2016, vlera prej 246.191 lekë lekësh, si kosto të udhëtimeve të bashkëshortit, përballuar me shpenzime të buxhetit të shtetit ose me financim nga organizatorët e aktiviteteve përkatëse.

23.6.6. Trupi gjykues, në përfundim të analizës financiare të kryer për vitin 2016, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, duke reflektuar në analizën financiare vetëm mbi shpenzimet e udhëtimeve, arriti në përfundimin se sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe kryerjen e pagesave për automjetin dhe shpenzime të tjera, duke rezultuar me bilanc negativ total për vitin 2016 në vlerën -209.181 lekë.

23.6.7. Trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkaqe ligjore për të ngarkuar me përgjegjësi ligjore subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, lidhur me rrethanat mbi ligjshmërinë e gjendjes *cash* të deklaruar nga z. G. H. në vitet 2003 – 2004. Referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat mbi ligjshmërinë e gjendjes *cash* të deklaruar nga z. G. H. në vitet 2003 – 2004, lidhet posaçërisht me të, si subjekt rivlerësimi në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm nga një tjetër trup gjykues.

23.6.8. Ky vendim i trupit gjykues, në asnjë rast, nuk paragjykon të drejtën për një hetim të pavarur të paanshëm dhe rivlerësim të tij në përputhje me provat që i përkasin çështjes së tij.

GJETJE TË TJERA NGA HETIMI ADMINISTRATIV

24. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se huaja e marrë nga “Emporiki Bank nga subjekti i rivlerësimit është shlyer tërësisht në datën 2.2.2011.

24.1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 2.2.2011 kam shlyer plotësisht kredinë bankare marrë në datën 2.4.2009 nga ‘Emporiki Bank’, në shumën 24.498 euro”, dhe në të njëjtën deklaratë deklaroi se: “kam marrë hua shumën prej 25.000 euro nga prindërit e mi, pa interes dhe pa afat për shlyerjen e kredisë bankare të sipërcituar”.*

24.2. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar se: *“... hua pa interes dhe pa afat në shumën 25.000 euro, marrë nga prindërit e mi, shuma e cila shërbeu për shlyerjen e kredisë së marrë në datën 2.4.2009 në ‘Emporiki Bank’, kredi e cila është shlyer tërësisht në këtë bankë në datën 2.2.2011”.* Në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar këtë huan pa shlyer ndaj prindërve të saj.

24.3. Nga hetimi i Komisionit është evidentuar se në datën 2.2.2011 është derdhur pranë kësaj banke nga znj. A. Ç. shuma 24.500 euro për efekt shlyerje huaje. Komisioni ka pyetur subjektin për arsyen e derdhjes së shumës monetare nga motra e saj dhe jo nga huadhënësit.

24.4. Në përgjigje të pyetësorit të dytë, subjekti ka shpjeguar se: *“Lidhur me faktin që shuma prej 24.500 euro është derdhur në datën 2.2.2011, në ‘Emporiki Bank’ nga motra ime znj. A. Ç., ju bëj me dije se kjo derdhje është kryer prej saj për lehtësi veprimi, si rezultat i faktit që kjo shtetase kryen aktivitete shumë të shpeshta me bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë”.*

24.5. Për shkak të marrëdhënies së huas së krijuar, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhënë hua prej 25.000 euro nga prindërit e saj.

24.6. Në përgjigje të pyetësorit të dytë dërguar nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se: *“Burimi i krijimit të kësaj shume dhënë hua nga prindërit e mi, përbëhet nga kursimet e tyre familjare deri në datën e dhënies së kësaj huaje, nga pensioni i tyre dhe shuma prej 40.000 lekësh/muaj që motra ime znj. A. Ll. (Ç.) i ka dhënë prindërve të mi prej vitit 1995 e në vijim pa ndërprerje me qëllim përmbushjen e nevojave për jetesë që këta shtetas mund të kenë pasur nga viti 1995”.*

24.7. Për të provuar dhënien e kësaj shume hua pa interes nga prindërit e saj, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratë noteriale lëshuar nga prindërit Xh. dhe L. Ll..

24.8. Për periudhën 2003 – 2010, subjekti ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e përfituara nga motra e saj nga dhënia me qira e objekteve në favor të “****” (ish-****) si dhe provat se tatimi është paguar nga ana e qiramarrësit.

24.9. Nga dokumentacioni i administruar për disa kontrata qiraje³ të lidhura shuma e përfiturat gjatë viteve 2003 – 2010, rezulton të jetë rreth 83 milionë lekë.

³Kontrata nr. ***, datë 30.12.2002, qiradhënësi A. Ll. dhe qiramarrësi *** (sot “****”) qiraja 4.500 USD/muaj; Aneks kontrata nr. ***, datë 14.1.2003, qiradhënësi A. Ll. dhe qiramarrësi *** (sot “****”) qiraja 500 USD/muaj; kontrata nr. ***, datë 19.12.2003, qiradhënësi A. Ll. dhe qiramarrësi “****” qiraja 5.000 USD/muaj; kontrata nr. ***, datë 16.1.2007 (me afat prej datës 1.1.2008) qiradhënësi A. Ll. dhe qiramarrësi “****”, qiraja 14.000 euro/muaj.

24.10. Në kuadër të dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.3.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003”) detyrimi për deklarimin e të ardhurave ka qenë për subjektin, bashkëshortin dhe fëmijët madhorë dhe nuk ka pasur parashikim ligjor për deklarime nga prindërit e subjektit deklarues, detyrim i cili u vendos pas miratimit të ligjit nr. 45/2014.

24.11. Referuar provueshmërisë së të ardhurave të ligjshme ndër vite të motrës së subjektit dhe dispozitave të ligjit nr. 9049, datë 10.3.2003 për mungese detyrimi ligjor për deklarime nga prindërit e subjektit deklarues, trupi gjykues, arrin në përfundimin se prindërit e subjektit kanë patur mundësi financiare për të akumuluar kursim në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, të mjaftueshëm për të financuar dhënien e huas subjektit, në vlerën prej 25.000 euro.

24.12. Ky konkluzion i trupit gjykues mbajti në konsideratë edhe sa ZVRPP-ja konfirmoi se në emër të prindërve të subjektit, Xh. dhe L. Ll., nuk figuronin pasuri të paluajtshme.

25. Gjatë hetimit⁴ ka rezultuar se nëna e subjektit ka kryer një veprim noterial shitblerjeje dhurim pasurie të paluajtshme nga 15.000.001-50.000.000, në datën 3.8.2018, pranë noterit A. A. M..

25.1. Komisioni i kërkoi⁵ noterit publik praktikën mbi veprimin e dhurimit të kryer në datën 3.8.2018. Sipas kontratës së dhurimit të pjesëve të pasurive të paluajtshme nr. ***, personi i lidhur me subjektin, znj. L. Ll., bashkë me katër shtetas të tjerë (M. G., P. B., S. M. dhe H. M.) i dhurojnë shtetasit A. K. pjesët takuese të secilit mbi 7 pasuri tokë truall dhe ndërtesë të ndodhur në Kavajë.

25.2. Nga ky transaksion nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

26. Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi pagesë për studime doktorature në Universitetin *** (***) për vete dhe për bashkëshortin në vlerën 2.000 euro secili, pra, 4.000 euro gjithsej.

26.1. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar shtim të ardhurash *neto* nga tërheqja e pagesës së bërë prej bashkëshortit të saj në janar të vitit 2015, në vlerën 2.000 euro.

26.2. Subjekti ka bashkëlidhur në cilësinë e provës *statement* bankar, datë 17.10.2019, mandatet e BKT-së lidhur me tërheqjen e kryer në datën 21.9.2016 nga ish-bashkëshorti dhe dy mandatet më 31.8.2018 dhe më 19.12.2018, lidhur me tërheqjet e kryera, akte këto të cilat janë administruar dhe vlerësuar nga Komisioni në kuptim të analizës financiare.

26.3. Nga ky transaksion nuk u evidentuan problematika apo *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

27. Nga verifikimi i policave të sigurimit⁶ rezultoi se në datën 16.11.2012 është lëvruar nga “Credins Bank” shuma 250.000 lekë, mbi bazën e të cilës është paguar edhe polica e sigurimit të jetës për hua. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, e cila ka sqaruar se: “*Kjo shumë i përket kontratës për kartë krediti që është lidhur mes meje dhe kësaj banke pasi ka filluar derdhja mujore e pagës nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kartë krediti e cila së bashku me policën e sigurimit të jetës pjesë integrale në ofertë e praktikës së kartës së kreditit, më është akorduar pas hapjes së llogarisë për lëvrimin e pagës.*”

⁴Shihni praktikën e shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë.

⁵Shkresë me nr. *** prot., datë 15.10.2019, dhe kthim përgjigjeje, datë 16.10.2019, të noterit A. A. M..

⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2019, të AMF-së.

27.1. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës nxjerrje llogarie për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2013, lëshuar nga “Credins Bank” për znj. Elbana Lluri, datë 14.10.2019, sipas të cilës teprica fillestare e akorduar nga kjo bankë për llogarinë në kartë krediti është 0 (zero) lekë dhe teprica në datën e mbylljes së kësaj llogarie është përsëri 0 (zero) lekë.

27.2. Gjithashtu, për të provuar se kjo kartë krediti nuk ka asnjë veprim të kryer dhe në këtë mënyrë asnjë kredi të akorduar ndaj saj nga “Credins Bank”, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë (*statement*) bankare të datës 19.3.2013 për periudhën 1.1.2012 – 18.3.2013.

27.3. Nga sa më sipër nuk u evidentuan problematika apo *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

28. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit tip "Opel" në vitin 2010.

28.1. Nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se subjekti ka blerë një automjet tip “Opel” në datën 7.12.2006, në shumën 250,000 lekë shitur në datën 18.5.2010, në shumën 500.000 lekë.

28.2. Subjekti ka bashkëlidhur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.10.2019, lëshuar nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., mbi *riparimin e automjetit të znj. Elbana Lluri dhe vlerën përkatëse të këtij riparimi të kryer.*

28.3. Çmimi i referuar në kontratën e shitjes dhe shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit binden trupin gjykues mbi vlerën reale të shitjes duke përfshirë edhe shpenzimet për përmirësim të kryera për këtë automjet, të cilat kishin sjellë rritjen e vlerës së tij.

29. Në lidhje me automjetin tip “AUDI”, në përdorim

29.1. Në përgjigje të pyetësorit standard në datën 16.10.2017, subjekti ka deklaruar përdorimin e automjetit “AUDI”, me targa *** automjet i babait të z. G. H..

29.2. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime mbi të drejtat e përdorimit mbi këtë automjet. Në përgjigje, subjekti sqaroi se: *“Referuar kontratës së huapërdorjes nr. ***, datë 7.7.2011, ish-vjehri im i ka dhënë të drejtën e përdorimit të këtij automjeti ish-bashkëshortit tim z. G. H., por në disa polica sigurimi, figuron edhe emri im si e siguruar me kartonin jeshil.*

Në kushtet kur unë nuk kam qenë asnjëherë drejtuese e këtij automjeti si brenda ashtu edhe jashtë vendit, por në cilësinë e pasagjeres kam shoqëruar bashkëshortin tim, i cili ka drejtuar gjithmonë dhe ka pasur i vetëm të drejtën e përdorimit për këtë automjet në bazë të kontratës së sipërcituar, kam bërë këtë deklaram në pyetësorin e dërguar nga ana juaj në datën 16.10.2017 (pyetja 5 e tij), për shkak se në momentin e plotësimit të këtij pyetësori, figuroja e martuar me këtë shtetas”.

29.3. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova per burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga babai i bashkëshortit.

29.4. Subjekti në përgjigje të barrës së provës ka sqaruar se: *“Me gjithë përpjekjet e mia për të marrë informacion për të ardhurat e babait të ish-bashkëshortit, e kam pasur realisht të pamundur për siguruar ato dhe informacionet që kam arritur të marrë janë shumë të përgjithshme. Po kështu, për sa kohë babai i ish-bashkëshortit nuk është person i lidhur i imi por i ish-bashkëshortit tim, i cili është nën hetim nga ana juaj, nga një trup tjetër gjyqësore, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 mund të japi informacion të plotë dhe të saktë në lidhje me këtë pasuri”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm.

29.5. Sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, procesi i kontrollit të ligjshmërisë së burimeve dhe të ardhurave në funksion të rivlerësimit kalimtar parasheh edhe detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të huadhënësit.

29.6. Trupi gjykues mban parasysh se në rastin konkret referuar kontratës së huapërdorjes nr. 3722/3722, datë 7.7.2011, pronari i mjetit i ka dhënë të drejtën e përdorimit të këtij automjeti djalit te tij z. G. H., para martesës së tij me subjektin e rivlerësimit.

29.7. Kontrata e përdorimit të këtij automjeti me akt noterial, provon personin që zotëron sendin në bazë të vullnetit të pronarit, ligjërisht duke provuar se z.G. H. është edhe mbajtësi i të drejtës reale të përdorimit dhe, për pasojë, është detyrimi i tij të provojë ligjshmërinë e burimit për krijimin e kësaj pasurie prej babait të tij.

29.8. Referuar nenit Ç, pika 1, e Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, kjo pasuri e luajtshme sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duhet ti nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, nga përdoruesi i këtij automjeti z.G. H., në procesin administrativ të kryer ndaj tij nga një tjetër trup gjykues.

29.9. Ky konkluzion i trupit gjykues mbi detyrimin e parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafët 1 dhe 4, vlerësohet në referim edhe të rrethanave faktike të subjektit të rivlerësimit, dhe faktit se huapërdorja e këtij mjeti është dakordësuar mes bashkëshortit të subjektit e babait të tij, para martesës së dy subjekteve të rivlerësimit, dhe faktit se subjekti kishte mjet tjetër në pronësi.

30. Në lidhje me disa transaksione në llogari të subjektit dhe personit të lidhur.

30.1. Subjekti, i pyetur nga trupi gjykues mbi transaksionet e kryera në llogari nga motra e bashkëshortit, ka shpjeguar se ato janë kryer për efekt garancie financiare që kërkohej për marrjen e vizave për udhëtime jashtë vendit.

30.1.1. Këto derdhje, referuar veprimeve bankare për shkak se kanë shërbyer vetëm për këto garanci, janë rikthyer në periudha tepër të shkurtra kohore për çdo depozitim.

30.1.2. Një fakt i tillë provohet nga transaksionet e kryera sipas të cilave janë depozituar dhe tërhequr të njëjtat shuma në një kohë të shkurtër vetëm për këtë qëllim dhe kopje e vizave të marra në të njëjtën periudhë me transaksionet e kryera.

30.2. Në mbështetje të shpjegimeve të sipërcituara, subjekti ka paraqitur kopjen e vizave pranë ambasadave përkatëse, të cilat përkonin me periudhën kur janë kryer transaksionet.

30.3. Trupi gjykues pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se për sa i përket këtyre transaksioneve subjekti ka arritur të provojë dhe të shpjegojë qëllimin e këtyre transaksioneve bankare mes familjarëve.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

31. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

31.1. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2012 në vlerën -691.723 lekë dhe gjatë vitit 2016 në vlerën -209.181 lekë, në një vlerë totale prej -900.904 lekësh për gjithë periudhën e deklarimit si rezultati final financiar negativ pas analizës financiare të përditësuar, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

31.2. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, (i) përgjegjësia për të provuar rrethanat dhe ligjshmërinë e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese marrë nga z. G. H., (ii) përgjegjësia për të provuar ligjshmërinë e gjendjes *cash* para fillimit të detyrës nga z. G. H. dhe (iii) përgjegjësia për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për pasurinë e luajtshme, automjetet në përdorim të z. G. H. nga babai i tij, janë rrethana që lidhen drejtpërdrejt me të si subjekt rivlerësimi në procesin administrativ të kryer ndaj tij nga një tjetër trup gjykues.

31.3. Trupi gjykues vlerëson se faktet e referuara më sipër në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë

B. KONTROLLI I FIGURËS

32. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 1.3.2019, të KDZH-së, ku rezulton se:

32.1. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.

32.2. Për subjektin e rivlerësimit Elbana Lluri, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të kimit të organizuar.

Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Elbana LLuri.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

32.3. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

32.4. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

33. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kreut VI, nenit 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016,

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ka lëshuar një raport të hollësishëm, si vijon.

33.1. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Elbana Lluri kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor, i kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre dhe shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Identifikon rastet kur për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertë të fushës dhe duke parashtruar pyetje të qarta, si dhe i qëndron korrekt zbatimit të detyrave të lëna nga gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes. Në një rast ka shqyrtuar kërkesën për vleftësim dhe caktim mase sigurimi në respektim të rregullave procedurale penale. Ajo njeh parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare.

33.2. Përgjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj gjyqtarës Elbana Lluri janë paraqitur 16 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 14 janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, ndërsa 2 ankesa janë verifikuar lidhur me procedurën e hedhjes së shortit dhe njëanshmëri në gjykim dhe pas verifikimit të tyre ka rezultuar se nuk ka pasur shkelje nga ana e saj.

33.3. Subjekti Elbana Lluri, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Në formularin e vetëdeklarimit, në rubrikën e të dhënave statistikore, ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për periudhën 1.1.2014 – 8.11.2016, në cilësinë e gjyqtarës në këtë gjykatë, 1139 çështje dhe 198 masa sigurimi, gjithsej 1337 çështje gjyqësore. Për këtë periudhë ka deklaruar se ka përfunduar 940 çështje gjyqësore dhe 198 masa sigurimi, gjithsej 1138 çështje. Gjithashtu, znj. Elbana Lluri ka deklaruar se për periudhën 8.11.2016 – 31.12.2016, në cilësinë e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, i janë caktuar 14 çështje si relatores, 47 si anëtare dhe ka mbartur gjithsej 1 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në këto të dhëna është 85.1 %.

33.4. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 1 vit, 2 muaj e 27 ditë ka qenë çështje civile themeli, ku për shkak se për zgjidhjen e drejtë të saj duhen njohuri të posaçme, janë thirrur ekspertë të fushës dhe në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli pranimi i padisë. Në tri dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 25 ditë, 9 muaj e 4 ditë dhe 8 muaj e 4 ditë. Ndër këto pesë dosje të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste, të cilat janë çështje civile themeli që ka gjykuar në përbërje të dhomës civile të seksionit të përgjithshëm, nuk është respektuar afati ligjor dhe standard i gjykimit. Shkak për tejkalimin e afatit për dosjet e vëzhguara ka qenë sjellja e palëve në proces, lënia e seancave larg nga njëra-tjetra për shkak të ngarkesës së lartë sasiore, si dhe lejes vjetore të gjyqtarëve gjatë muajit gusht. Ndërsa çështja që është gjykuar brenda ditës ka qenë çështje penale masë sigurimi, ku kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti ka respektuar natyrën urgjente të këtyre kërkesave dhe, rrjedhimisht, ka respektuar edhe standardin e procesit të rregullt ligjor.

33.5. Subjekti Elbana Lluri, në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 1 seminar të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 1 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimit ka një lidhje të arsyeshme kryesisht me detyrën e gjyqtarës së shkallës së parë, të organizuar në seksionin civil. Gjyqtarja ka paraqitur 12 certifikata për trajnime të ndryshme nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizma të tjerë, të cilat janë jashtë periudhës së rivlerësimit, konkretisht në periudhën mars

1998 – prill 2006. Ka deklaruar se ka qenë redaktore shkencore e botimit në shqip të Kodit Civil italian dhe ka botuar artikuj shkencorë në revistën “Jeta juridike”.

33.6. Konkluzioni për vlerësimin profesional

Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme dhe në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

34. DENONCIMET

Komisioni ka analizuar denoncimet për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, si vijon:

34.1. Denoncimi i shtetasit M. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.2.2018, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues që kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes së tij në Gjykatën e Apelit Tiranë, me objekt: vendim i padrejtë, proces jo i rregullt ligjor.

34.1.1. Nga përmbajtja e denoncimit rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 3.10.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 25.8.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke caktuar si masë sigurimi personal ndaj këtij shtetasi “arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

34.1.2. Ankuesi pretendon se në marrjen e këtij vendimi gjykata e apelit nuk ka verifikuar faktin nëse kishte kompetencë tokësore, pasi vepra penale për të cilën akuzohej kishte ndodhur në juridiksionin tokësor të rrethit Durrës.

34.1.3. Gjithashtu, ankuesi pretendon se gjykimi është bërë pa pjesëmarrjen e tij dhe pa njoftuar avokatin e përzgjedhur, ndonëse njihej adresa e tij dhe e avokatit, për pasojë, prej tij pretendohet se është zhvilluar një gjykim formal, duke u mohuar në mënyrë arbitrare e drejta për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

34.1.4. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2020, kërkoi dosjen gjyqësore, në vijim të së cilës, me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë e dërgoi atë.

34.1.5. Pas administrimit të dosjes së plotë gjyqësore, si dhe konkretisht të dosjes që lidhet me vendimin nr. ***, datë 3.10.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti ka pasur cilësinë e anëtarit, Komisioni vëren se çështja ka përfunduar në të tria shkallët e gjykimit. Me vendimin nr. ***, datë 16.2.2018, të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, trupi gjykues ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga i dyshuari M. B. kundër vendimit nr. ***, datë 3.10.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për arsye se nuk i përmbahet shkaqeve që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni, pasi vlerësoi dosjen gjyqësore, konstatoi se:

34.1.6. Me njoftimet me nr. *** prot., datë 15.9.2017, telegram me përgjigje, janë njoftuar për seancë në datën 20.9.2017, ora 10:00, shtetasi M. B., përkthyesi A. H. dhe avokati M. Rr.. Këto njoftime nuk kanë bashkëlidhur aktin e shërbimit postar apo të ftuesit të gjykatës. Me shkresën e datës 29.9.2017, të dërguar nëpërmjet shërbimit postar, përkthyesi A. H. vë në dijeni relatorin e çështjes se në datën 20.9.2017, rreth orës 11:00 (pra në datën e seancës, 1 orë pas orës së gjykimit)

ka marrë në dorëzim telegramin me përgjigjen nr. *** akti, datë 15.9.2017, sipas të cilit është njoftuar për seancën dhe se ndodhej me banim në Krujë. Kjo shkresë është protokolluar nga gjykata e apelit me shkresën nr. ***, datë 2.10.2017.

34.1.7. Në vijim, me shkresat po me të njëjtin numër protokoll (nr. *** akti, datë 15.9.2017) dhe të pafirmosura nga relatori i çështjes, janë njoftuar për seancë në datën 3.10.2017, ora 9:45, av. M. Rr. dhe përkthyesi A. H.. As këto njoftime nuk kanë bashkëlidhur aktin e shërbimit postar apo të ftuesit të gjykatës. Ndërsa, për thirrjen e shtetasit M. B., relatori i çështjes i ka dërguar Komisarariatit të Policisë Rinas shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2019, me lëndë “urdhër për njoftimin dhe shoqërimin e personit nën hetim”. Vihet re se shkresa mban një datë përpara se çështja gjyqësore e caktimit të masës të ketë përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 25.8.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Edhe për këto njoftime nuk gjenden aktet që provojnë vënien në dijeni nga gjykata e apelit ndaj këtyre shtetasve për seancën gjyqësore të datës 3.10.2017.

34.1.8. Në procesverbalin gjyqësor të seancës së firmosur nga të tre anëtarët e trupit gjykues, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, përcaktohet se “u thirrën dhe nuk u paraqit personi nën hetim M. B., av. M. Rr. dhe përkthyesi A. H.” dhe vijon “rezulton se njoftimi është ezauruar në të gjitha format sipas ligjit”.

34.1.9. Lidhur me kompetencën tokësore: lidhur me faktin tjetër të paraqitur nga denoncuesi për sa i përket kompetencës tokësore, Komisioni, pasi verifikoi dosjen gjyqësore, nuk gjeti të referuar si shkak ligjor në ankim për prishjen e vendimit kompetencën, prandaj, bazuar në nenin 425⁷ “kufijtë e shqyrtimit të çështjes”, nuk u gjetën shkelje në drejtim të pretendimit për kompetencë tokësore.

34.1.10. Subjekti ka shpjeguar se pretendimi i paraqitur në denoncim lidhur me faktin se nuk është realizuar njoftimi për këtë shtetas, është i pa mbështetur në ligj dhe në prova. Gjykata e apelit ka ezauruar të gjitha mënyrat e njoftimit si për personin nën hetim, ashtu edhe për mbrojtësin e tij. Marrja dijeni e mbrojtësit të personit nën hetim provohet me dëftesën e komunikimit nr. *** prot., datë 5.9.2017, ku ka firmosur av. M. Rr., duke hedhur poshtë në këtë mënyrë pretendimin e ngritur lidhur me mungesën e njoftimit për këtë mbrojtës. Në kushtet kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë e kishte caktuar adresën e vendqëndrimit në hotel “***”, Rinas për personin nën hetim M. B., kjo ishte edhe adresa ku duhej të njoftohej ky shtetas, referuar detyrimit të tij ligjor për zbatimin e vendimit gjyqësor dhe se njoftimi në këtë adresë është kryer në të gjitha format e kërkuara nga ligji, me dëftesë komunikimi datën 25.8.2017, e cila ka shënimin “larguar”, me telegram me përgjigje, me shkresë drejtuar Komisarariatit të Policisë Rinas. Gjykata e apelit, në kushtet kur vetë personi nën hetim i shmangej gjykimit të masës së sigurimit për shkak se edhe avokati i zgjedhur prej tij përsëri edhe pse kishte dijeni për seancën nuk u paraqit në gjykim, ka proceduar me deklarimin e mungesës dhe caktimin e një mbrojtësi kryesisht për këtë shtetas.

Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, dosjen gjyqësore në ngarkim të shtetasit M. B. (112 fletë).

34.2. Denoncimi i shtetas S. K. (J.), regjistruar me nr. *** prot., datë 20.3.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit. Sipas denoncueses subjekti, në cilësinë e relatores së çështjes të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ka zvarritur procesin, duke e shtyrë pa arsye, ka shqyrtuar dhe pranuar kundërpadinë jashtë afatit ligjor lidhur me një çështje gjyqësore detyrim njohje

⁷ Gjykata e Apelit e shqyrtonte çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim.

bashkëpronare dhe dorëzim të pasurisë së trashëguar në favor të saj ka treguar sjellje gjatë shqyrtimit.

34.2.1. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2020, kërkoi dosjen gjyqësore, në vijim të së cilës, me shkresën nr. *** prot., datë 11.9.2020, Gjykata e Lartë e dërgoi atë.

34.2.2. Pas vlerësimit të dosjes gjyqësore që lidhej me vendimin nr. ***, datë 1.2.2019, Komisioni ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatores së çështjes, në seancën gjyqësore të datës 13.12.2018, pas konstatimit të të metave të ankimit, e shtyn seancën për t'i dhënë mundësinë palës së paditur kundërpaditëse të plotësojë ankimin brenda afatit 5-ditor.

34.2.3. Pala e paditur kundërpaditëse e ka depozituar ankimin e plotësuar në gjykatë më 18.1.2019 dhe ky fakt i është bërë i ditur subjektit të rivlerësimit nga pala paditëse e kundërpaditur në seancën e datës 29.1.2019.

34.2.3.1. Subjekti i ka paraqitur Komisionit shpjegime lidhur me veprimet procedurale që nga data e shpalljes së vendimit në gjykatë rrethi, veprimet procedurale të kryera nga zënia e afatit dhe deri në plotësimin e të metave të ankimit nga pala e paditur kundërpaditëse, duke sqaruar se:

34.2.3.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 3.7.2017, ka vendosur:

*- Pranimin e pjesshëm të padisë; - Detyrimin e të paditurit kundërpaditës J. J. të njohë paditësen e kundërpaditur S. K. (J.) bashkëpronare në 1/6 (një të gjashtën) pjesë dhe të dorëzojë pasurinë trashëgimore që vjen nga trashëgimlënësja A. J. mbi pasurinë 351 m² truall dhe shtëpisë me katër dhoma, sipas dokumentit hipotekor nr. ***, datë 2.11.1994; - Njohjen e të drejtës reale të pronësisë për pjesën takuese të përfutuara si më sipër nga transferimi i kësaj pasurie; - Rrëzimin e kundërpadisë si të pabazuar në prova e në ligj...*

34.2.4. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim (zënie afati) shtetasja S. K. (J.) në datën 17.7.2017 dhe pas ankimit të plotësuar në datën 8.9.2017, ka kërkuar pranimin e plotë të kërkesëpadisë.

34.2.5. Njëkohësisht ka ushtruar kërkesë ankimi i padituri J. J. (Xh.) në datën 17.7.2017, duke zënë afatin e ankimit për shkak se nuk është zbardhur vendimi i arsytuar dhe duke i kërkuar sekretarisë së gjykatës që të pranohet ankimi pasi të bëhet plotësimi i tij.

34.2.6. Referuar dëftesave të komunikimit të ndodhura në dosjen gjyqësore rezulton se me dëftesën e komunikimit nr. ***, datë 11.9.2017, drejtuar përfaqësueses së denoncueses, i është njoftuar zënia e afatit të ankimit e ushtruar nga shtetasi Jovan Joxhe, për të cilën ka marrë dijeni në datën 13.9.2017. Njëkohësisht, po me të njëjtën dëftesë drejtuar këtij shtetasi i është njoftuar ankimi i ushtruar nga shtetasja S. K. (J.), për të cilin ka marrë dijeni në datën 13.9.2017.

34.2.7. Rezulton se seanca e parë gjyqësore e zhvilluar në gjykatën e apelit mbi ankimin e ushtruar nga të dy palët ndërgjyqëse ka qenë ajo e datës 15.11.2018. Në këtë seancë, avokati i palës së paditur J. J., av. I. Ll., i ka bërë me dije gjykatës faktin se shtetasi J. J. ka ndërruar jetë dhe është kërkuar pezullimi i gjykimit të çështjes deri në nxjerrjen e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin. Gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të të paditurit të ndjerë dhe ka shtyrë seancën për një afat të gjatë kohor për të bërë të mundur që nga përfaqësuesi i të ndjerit të nxirrej dëshmia e trashëgimisë, e cila pasi të depozitohet në gjykim të bënte të mundur kryerjen e kalimit procedural nga i ndjeri tek trashëgimtarët ligjorë të tij.

34.2.8. Në seancën e radhës, më 13.12.2018, av. I. Ll. ka depozituar dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Th. J., duke u paraqitur edhe prokura përkatëse e të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të tij, të cilët kishin shprehur vullnetin të përfaqësoheshin në gjykim nga i njëjti përfaqësues.

34.2.9. Gjykata, në bazë të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile, ka kryer kalimin procedural për të paditurin Th. J., duke thirrur në gjykim me të njëjtën cilësi trashëgimtarët ligjorë të tij të përfaqësuar nga av. I. Ll. Pasi është ezauruar ky veprim procedural, në seancën e datës 13.12.2018, në kushtet kur palës së paditur J. J. nuk i ishte komunikuar kopje e plotë e vendimit të arsyetuar të gjykatës për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës së ankimit, trupi gjykues i ka lënë afat 5-ditor për plotësimin e ankimit.

34.2.10. Subjekti ka theksuar: *“Në rastin konkret, në kundërshtim me sa është pretenduar nga denoncuesja S. K. (J.), nuk ndodhemi vetëm përpara plotësimit të të metave të ankimit nga i padituri J. J., por përpara mungesës së komunikimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar për këtë shtetas dhe ankimit të plotë të realizuar nga S. K. J. ndaj këtij vendimi. Sekretaria gjyqësore duhej të kishte kryer dy veprime procedurale të pavarura, që janë së pari komunikimi i vendimit të plotë për të paditurin e ndjerë J. J. në mënyrë që ky shtetas të ushtronte ankimin e plotësuar dhe njëkohësisht komunikimin e ankimit të plotësuar për të, të ushtruar nga S. K. (J.), veprime të cilat nuk janë kryer rregullisht nga kjo sekretari. Në këto kushte, gjykata e apelit kishte detyrimin t’i komunikonte trashëgimtarëve të të paditurit të ndjerë kopjen e plotë të ankimit të ushtruar nga S. K. (J.), për të cilin ata brenda afatit 5-ditor kishin të drejtën të ushtronin kundërankim dhe njëkohësisht vendimin e plotë të arsyetuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin brenda afatit 15-ditor kishin të drejtë të ushtronin ankim, në kushtet kur këta trashëgimtarë kishin hyrë në gjykim me cilësinë e të paditurit pikërisht në këtë seancë gjyqësore. Rezulton se referuar aktit për plotësimin e ankimit, ky ankim është ushtruar nga tre të paditurit e rinj në datën 20.12.2018, pra, brenda afatit 5-ditor dhe është depozituar në protokollin e gjykatës së apelit në datën 18.1.2019, pasi sipas deklarimeve të avokatit të të paditurve është dërguar me postë prej tij. Pikërisht për të bërë të mundur që pala e paditur në kushtet kur sapo kishte hyrë në gjykim në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit të paditur J. J., të ushtronte të drejtat e saj procedurale në përputhje me parimin e një procesi të rregullt ligjor, gjykata e apelit ka pranuar ankimin e ushtruar, në kushtet kur ky ankim është ushtruar brenda afatit të përcaktuar në nenin 443 të Kodit të Procedurës Civile.”*

34.2.11. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë të dosjes gjyqësore në ngarkim të shtetases S. K. (J.) (87 fletë).

34.3. Denoncimi i shtetases L. D., regjistruar me nr. *** prot., datë 22.11.2017, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe disa gjyqtarëve të tjerë, me objekt: qëndrim i njëanshëm dhe vendim i padrejtë, si dhe shkelje etike gjatë procesit gjyqësor.

34.3.1. Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit disa akte⁸ që lidhen me të. Nga administrimi i përmbajtjes së denoncimit dhe fakteve sipas akteve bashkëlidhur rezultoi se denoncuesja ka pasur një konflikt pronësie në vitin 2011 me bashkëshortin e gjyqtarës A. C., e cila sipas denoncueses është mike me subjektin e rivlerësimit.

34.3.2. Subjekti ka paraqitur shpjegime të detajuara lidhur me çështjen, duke u shprehur se lidhet me zgjidhjen në themel të saj dhe faktin që në zgjidhjen e kësaj çështjeje ligjit material i është dhënë fuqi prapavepruese. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“.. pretendimi i paraqitur në denoncim se i kam dhënë fuqi prapavepruese ligjit material, nuk qëndron, pasi në themel të çështjes ka qenë përcaktimi i faktit nëse objektet e trajtuara me kontratat e privatizimit ishin ose jo pjesë e një vendimi të marrë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kthimin*

⁸ Certifikatë për vërtetim pronësie; kontratë shitblerjeje e lidhur me Nd. Komunale, autorizim, kontratë privatizimi banese, ankim viti 2011 ndaj vendimit nr. ***, datë 18.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendim nr. ***, datë 8.10.2007, i AKKP-së; shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2011, e KLSH-së; raport për kontrollin e ushtruar në ZVRPP-në Tiranë, korrik 2008, kopje të gazetave të shtypit të përditshëm.

e pronës ish-pronarit. Në kushtet kur ligji 'Për kthimin dhe kompensimin e pronës 'prevalon mbi ligjet e zakonshme, siç është edhe ai nr. 7652, datë 23.12.1992 'Për privatizimin e banesave shtetërore', kam konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratave të privatizimit, duke i rikthyer të drejtën ish-pronarit të shpronësuar, duke mos u shprehur në asnjë moment lidhur me ndonjë fuqi prapavepruese për asnjë nga ligjet e sipërcituara. Ky vendim është ankimuar nga denoncuesja edhe në gjykatat më të larta, me të njëjtat shkaqe ankimi si ato të pretenduara në denoncim dhe është lënë në fuqi prej tyre duke qenë një vendim gjyqësor i formës së prerë, për sa i përket zgjidhjes së çështjes në themel dhe bazueshmërisë së saj në ligj dhe në prova.

Për sa i përket pjesës së denoncimit sipas të cilit ky vendim është dhënë nga ana ime për shkak se paditësi ishte bashkëshorti i një gjyqtareje në të njëjtën gjykatë, dua të ritheksoj se gjatë gjithë viteve të ushtrimit të detyrës si gjyqtare, i nënshtrohem vetëm ligjit dhe së drejtës, duke u përprjekur maksimalisht të mos ndikohem nga asnjë rrethanë apo faktor i jashtëm në dhënien e vendimit. Edhe në rastin konkret, vendimi i dhënë nuk ka asnjë lidhje me faktin e pretenduar, pasi gjyqtarja A. C. (Z.) së pari nuk është shoqja ime por kolege që ushtron të njëjtin funksion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në asnjë rast nuk ka kryer asnjë veprim që të ndikonte në dhënien e këtij vendimi, fakt i cili nëse do të kishte ndodhur do të përbënte vepër penale me pasoja përkatëse ligjore. Zgjidhja e çështjes në themel është shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta të cilat kanë arritur në të njëjtin konkluzion siç edhe unë jam shprehur në vendim. Për më tepër, pretendimi lidhur me etikën e përdorur nga ana ime është krejtësisht i pavërtetë, pasi jo vetëm nuk gjen mbështetje ligjore në asnjë provë të depozituar bashkëlidhur denoncimit, por edhe cenon figurën time si gjyqtare në kushtet kur shprehje të tilla nuk i kam përdorur në asnjë rast gjatë ushtrimit të detyrës.

Për sa më sipër, çmoj se pretendimet e paraqitura në denoncim janë të pavërteta dhe nuk duhet të merren parasysh nga ana e këtij Komisioni dhe janë shqyrtuar me vendim të formës së prerë si nga Gjykata e Apelit Tiranë, ashtu edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë”.

Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetases L. D. (19 fletë).

34.4. Denoncimi i shtetasit P. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 24.11.2007, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe disa gjyqtarëve të tjerë, me objekt: shpërdorim detyre me anë të mashtrimit dhe falsifikimit të përmbajtjes së akteve gjyqësore dhe të dokumenteve, duke e mbështetur në disa akte bashkëlidhur.

34.4.1. Denoncuesi ka trajtuar disa fakte që lidhen me një konflikt gjyqësor të lindur me një ortak për shkak të një marrëveshjeje ortakërie, konflikt i cili është zgjidhur nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me ligjin material dhe procedural.

34.4.2. Shtetasi P. B. ka denoncuar fakte që lidhen me shqyrtimin e padisë dhe përfundimin e saj nga subjekti i rivlerësimit, duke u shprehur se subjekti ka falsifikuar padinë, duke e kthyer nga padi e përmbushjes së detyrimit tregtar në padi të përmbushjes së detyrimit civil, e cila përfundon me njohjen pronar. Gjithashtu, denoncon se subjekti ka ndryshuar bazën ligjore të objektit të padisë, ka ndryshuar padinë dhe objektin e saj pa kërkesë të palëve ndërgjyqëse apo pa vendim.

34.4.3. Ky shtetas ka trajtuar edhe disa fakte të tjera, të cilat në vlerësimin e Komisionit i përkasin materies së konfliktit midis palëve apo pretendime të natyrës juridiko-penale dhe nuk bën pjesë në kompetencat e tij. Komisioni administroi aktet e paraqitura nga denoncuesi dhe u ndal të vlerësonte nëse në to ka pasur shkelje ligjore nga subjekti që ndikojnë në kuptim të kriterëve të rivlerësimit kalimtar.

34.4.4. Nga administrimi i kërkesëpadisë datë 19.3.20009, me palë ndërgjyqëse: paditës L. L. dhe i paditur P. B., me objekt: detyrim të palës së paditur të përmbushë detyrimet e rrjedhura në aktmarrëveshjen datë 6.6.1995 , kreu V, pika 5/1, me bazë ligjore ligji nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, nenet 153, 420 dhe 423 të Kodit Civil, si dhe të vendimit nr. *** dhe nr. *** akti, datë 3.12.2009, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit është vendosur detyrimi i palës së paditur P. B. të përmbushë detyrimet e rrjedhura në aktmarrëveshjen nr. ***, datë 6.6.1995, duke u detyruar të njohë paditësin L. L. pronar të dy kateve të fundit të godinës 7-katëshe + kat nëntokësor të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 16.1.1997, me sip. 300 m² secili kat dhe 97.7 m² të katit përdhes, duke kryer edhe ndryshimet përkatëse në regjistrat e ZRPP-së Tiranë të kësaj pasurie.

34.4.5. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... thelbi i pretendimeve të ngritura në denoncim ka të bëjë me faktin se pala e paditur ka pretenduar se nuk ndodhemi përpara një aktmarrëveshjeje civile, por një marrëdhënieje ortakërie, e cila është ndryshuar në mënyrë të padrejtë nga ana e gjykatës.

*Referuar rrethanave të faktit, pala paditëse ka lidhur me të paditurin një aktmarrëveshje në datën 6.6.1995. Në themel të kësaj marrëdhënieje të krijuar ishte zhvillimi i një aktiviteti të përbashkët në fushën e shërbimeve dhe hotelerisë. Për realizimin e këtij qëllimi pala e paditur kishte marrë një leje ndërtimi për ndërtimin e një pallati 7-katësh, të ndodhur në rrugën *** nr. ***, Tiranë. I padituri denoncues, duke mos pasur mundësi financiare për ta realizuar vetë këtë ndërtim, ka lidhur marrëveshjen me paditësin, duke bërë të mundur që investimi i pallatit të kryhej nga të dy së bashku. Gjithashtu, të dy palët ndërgjyqëse, për të bërë të mundur vazhdimin e këtij aktiviteti, kanë krijuar edhe një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar *** sh.p.k., me anë të së cilës do të realizonin edhe qëllimin e investimit të përbashkët mes tyre.*

Pala paditëse ka përmbushur detyrimet e rrjedhura nga marrëveshja e lidhur me të paditurin, duke kryer edhe investimin përkatës në objekt. Por, pas përfundimit të objektit në nivel apartamentesh, pala e paditur nuk e kreu investimin e tij, duke lënë në këtë mënyrë katin e gjashtë dhe të shtatë të ndërtesës krejtësisht të papërfunduar.

Pala paditëse ka deklaruar në gjykim se fillimisht pronësia e këtyre ambienteve do të kalonte tek të dy paditësit me cilësinë e ortakëve të shoqërisë që ata kishin krijuar së bashku. Por, duke qenë se kjo shoqëri, sipas shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse, nuk ka funksionuar asnjëherë, paditësi pretendoi se nuk ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje tregtare, por një kontrate të shoqërisë së thjeshtë, sipas së cilës janë përcaktuar edhe të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile. Pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur nuk i ka përmbushur detyrimet e saj kontraktore për shkak se në përfundim të objektit e ka regjistruar të gjithë pjesën takuese të ndërtesës në emër të tij në regjistrat përkatës hipotekorë dhe, për këtë arsye, paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar përmbushjen e detyrimeve civile të rrjedhura nga marrëveshja e lidhur me të paditurin. ...Gjykata ka çmuar se mes palëve ndërgjyqëse është lidhur një kontratë e shoqërisë së thjeshtë e parashikuar në dispozitat përkatëse, nenet 1074 e vijues të Kodit Civil.

Neni 1074 i Kodit Civil parashikon se: ‘Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime.’

Palët ndërgjyqëse në aktmarrëveshjen e lidhur mes tyre në datën 6.6.1995 kanë parashikuar se vënë në dispozicion të krijimit të një shoqërie në të ardhme, kontribute përkatëse në para dhe shërbime.

Neni 1076 i Kodit Civil parashikon se: 'Anëtari është i detyruar të paguajë kontributet e caktuara në kontratën e shoqërisë. Presumohet se anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë në pjesë të barabarta midis tyre, sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.'

*Në gjykim nuk rezultoi që shoqëria e krijuar prej tyre *** sh.p.k., që është një person juridik i krijuar në një periudhë të mëvonshme nga nënshkrimi i aktmarrëveshjes objekt gjykimi, të ketë të përfshirë në kapitalin e saj pjesët respektive të ndërtimit në fjalë.*

*Pala denoncuese P. B., në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në aktmarrëveshje dhe në Kodin Civil, ka regjistruar në emër të tij të gjithë ato pjesë të godinës, të cilat, sipas marrëveshjes ishin investuar nga paditësi L. L.. Njëkohësisht, nuk rezultoi e provuar në gjykim që ky regjistrim në emër të të paditurit, të ishte kryer si ortak i tij në shoqërinë *** 'sh.p.k., apo si pjesë e kapitalit të kësaj shoqërie, por vetëm si pasuri personale e të paditurit si person fizik.*

*Padia e paraqitur nga paditësi L. L., në kundërshtim me sa ka pretenduar denoncuesi, është padia e detyrimit të njohjes pronar ndaj të paditurit në baze të kontratës së lidhur mes tyre në datën 6.6.1995, që është një marrëdhënie juridiko-civile e krijuar më parë se hartimi i aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë *** 'sh.p.k., që është edhe subjekti juridik i krijuar nga të dy ndërgjyqësit, mbi bazën e një shoqërie të thjeshtë. Ka qenë pikërisht ky përfundim i arritur nga ana ime në cilësinë e gjyqtarës së çështjes, përfundim i cili i është nënshtruar të gjitha shkallëve të gjyqimit dhe është çmuar i drejtë nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, në kushtet kur ky vendim gjyqësor është i formës së prerë dhe shkaqet e paraqitura nga denoncuesi, i janë nënshtruar në mënyrë të hollësishme këtij shqyrtimi”.*

34.4.6. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetasit P. B. (24 fletë).

34.5. Denoncimi i shtetasit F. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 5.12.2017, drejtuar subjektit të rivlerësimit, me objekt: korrupsion i hapur nga gjyqtarja në çështjen gjyqësore me palë të paditur M. H..

34.5.1. Komisioni shqyrtoi denoncimin dhe aktet bashkëlidhur dhe konstatoi se faktet e trajtuara i përkasin zgjidhjes së çështjes në materie dhe nuk referojnë në *indicie*, në kuptim të kriterëve të rivlerësimit për subjektin.

34.6. Denoncimi i shtetases A. N., regjistruar me nr. *** prot., datë 23.1.2018, drejtuar 31 subjekteve (gjyqtarë dhe prokurorë), përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: zvarritje në proces, aftësi profesionale dhe vendime në kundërshtim me ligjin.

34.6.1. Denoncuesja ka referuar se gjyqtarët, përfshirë edhe subjekti, kanë zvarritur gjykimin me objekt: njohje trashëgimie për vite radhazi.

34.6.2. Nga përmbajtja e këtij denoncimi nuk u evidentua të ishte i referuar emri i subjektit dhe as përshkrimi i ndonjë të dhëne që lidhej me të, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, denoncimi nuk mund të trajtohet, për sa nuk ka të dhëna lidhur me subjektin dhe as akt të referuar të marrë prej saj.

34.7. Denoncimi i shtetases N. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 26.1.2018, drejtuar subjektit dhe një gjyqtareje tjetër, me objekt: kontroll pasurie dhe aftësi profesionale.

34.7.1. Nga përmbajtja e këtij denoncimi nuk u evidentua *indicie* lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, denoncimi nuk mund të trajtohet, për sa nuk ka *indicie* lidhur me subjektin.

34.8. Denoncimet e shtetasit A. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 7.2.2019, dhe me nr. *** prot., datë 11.2.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, me objekt: cenim i të drejtës së aksesit në proces gjyqësor. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion bashkëlidhur.

34.9. Denoncimi i shtetasit M. P., regjistruar me nr. *** prot., datë 19.2.2019, drejtuar subjektit dhe dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, me objekt: vendim të padrejtë, i cili ka prishur vendimin e shkallës së parë pa pasur shkaqe ligjore.

34.9.1. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 16.10.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me një konflikt kundër shoqërisë “****” sh.p.k., për shkak të marrëdhënies së punës së denoncuesit pranë kësaj shoqërie. Në këtë vendim subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e anëtares.

34.9.2. Komisioni, pasi administroi vendimin, nuk konstatoi *indicie* të cilat cenojnë shkaqet e ankimit. Trupi gjykues ka disponuar me prishje vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, duke përcaktuar detyrat e lëna për të qartësuar situatën lidhur me marrëdhënien e punës, periudhën e punësimit, provueshmërinë e punësimit të tij/saj pranë organeve kompetente dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

34.10. Denoncimet e shtetasit K. Z., regjistruar me nr. *** prot., datë 26.2.2019, dhe me nr. *** prot., datë 7.3.2019, drejtuar subjektit dhe disa prokurorëve që kanë hetuar lidhur me kallëzimin e kryer ndaj tij.

34.10.1. Ky shtetas ka denoncuar subjektin për dhënie vendimi të padrejtë me objekt: vendim dhënien vendimi të padrejtë “masë sigurimi personal arrest në burg”. Komisioni administroi denoncimin dhe aktet bashkëlidhur, ku rezultoi se me vendimin nr. *** akti, datë 30.9.2013, subjekti ka vleftësuar si të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe ka vendosur caktimin e masës shtrënguese “arrest në burg”.

34.10.2. Në vendimin e marrë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar faktet penale, ka kryer analizë ligjore lidhur me ekzistencën e kushteve për arrestin në flagrancë, parashikuar në nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar në përfundim ligjshmërinë e plotë të arrestit në flagrancë, si dhe pasi ka vlerësuar kriteret e vendosjes së masës shtrënguese, duke i analizuar bazuar në nenet 228, 229, 238 dhe 245, ka çmuar se masa e arrestit me burg e kërkuar nga prokurori është në përshtatje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e faktit dhe personit i cili dyshohet se e ka kryer veprën penale.

34.10.3. Në përfundim, pas vlerësimit të vendimit nr. *** akti, datë 30.9.2013, nuk u gjetën *indicie* në kuptim të kriterëve të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

34.11. Denoncimi i shtetasit A. H., regjistruar me nr. *** prot., datë 26.2.2020, drejtuar subjektit të rivlerësimit në cilësinë e relatores, me objekt: cenimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe sjellje joprofesionale, cenim të figurës, integritetit si gjyqtare. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim.

34.12. Denoncimi i shtetasit V. Ç., regjistruar me nr. ***, datë 11.3.2019, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: korrupsion nëpërmjet shpërdorimit të detyrës me bashkëpunim me të tjerë.

34.12.1. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin. Denoncuesi nuk specifikon asnjë ankesë lidhur me subjektin e rivlerësimit.

34.13. Denoncimi i shtetasit G. A., regjistruar me nr. ***, datë 27.2.2020. Denoncuesi ankohet se nuk ka qenë dakord me vendimin e marrë nga trupi gjykues i gjykatës së apelit, ku subjekti ka

pasur cilësinë e gjyqtares, pasi ky trup gjykues ka favorizuar palën paditëse e cila nuk ka pasur dokumente të rregullta pronësie.

34.13.1. Komisioni administroi denoncimin dhe aktet bashkëlidhur, nga trajtimi i të cilave duket se denoncuesi është ankuar për një vendim të marrë nga subjekti dhe dy anëtarët e tjerë, për të cilin nuk ka qenë dakord lidhur me materien e zgjidhjes së çështjes.

34.13.2. Ky denoncim nuk duket të jetë objekt trajtimi nga Komisioni në kuptim të kriterëve të rivlerësimit për subjektin.

34.14. Denoncimi i shtetasit D. H., regjistruar me nr. *** prot., datë 28.2.2020, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues të gjykatës së apelit, si dhe gjyqtares në gjykatën e rrethit gjyqësor. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim.

34.15. Denoncimi i shtetasit D. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 6.3.2018, drejtuar disa subjekteve të rivlerësimit, me objekt: vendime të padrejta.

34.15.1. Nga administrimi i këtij denoncimi nuk u gjetën *indicie* sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të kriterëve të rivlerësimit për subjektin.

34.16. Denoncimet e shtetasit S. T., regjistruar me nr. *** prot., nr. *** prot., nr. *** prot., si dhe nr. ***, datë 22.5.2019, drejtuar disa subjekteve të rivlerësimit, me objekt: vendime të padrejta.

34.16.1. Nga administrimi i këtij denoncimi dhe dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi nuk u gjetën *indicie* sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të kriterëve të rivlerësimit për subjektin dhe se faktet që zgjidhin materien e çështjes nuk janë në kompetencën e Komisionit.

34.17. Denoncimi i shtetasit K. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 30.4.2018, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe disa subjekteve të tjera. Ky shtetas ka denoncuar se subjekti i rivlerësimit, në vendimin nr. *** akti, datë 2.3.2015, në shqyrtimin e çështjes me palë ndërgjyqëse: paditës K. K. dhe të paditur shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k. dhe person të tretë Komuna Kashar, me objekt: kthim prone dhe marrje mase sigurim padie nëpërmjet pezullimit të punimeve të ndërtimit. Sipas tij gjyqtarja ka caktuar një ekspert topograf pa pasur licencën e duhur, sikurse e kërkon legjislacioni në fuqi.

34.17.1. Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar se denoncuesi, në cilësinë e palës paditëse, ka kundërshtuar vetëm pas dy seancave të realizuara ekspertin e caktuar nga gjykata, znj. Irma Sula, me pretendimin se nuk kishte licencë për matje gjeodezike. Të paditurit e kanë kundërshtuar në seancë këtë pretendim, pasi pala paditëse kishte qenë prezente në seancën e caktimit të saj dhe kishte qenë dakord me ekspertin e caktuar nga gjykata, licencat e saj i ishin bërë me dije që në momentin e caktimit dhe vetëm pasi është njohur me përfundimet e aktekspertimit dhe duke mos qenë dakord me këtë akt, ka paraqitur pretendime lidhur me cilësinë e ekspertës. Gjykata, pasi ka marrë edhe mendimin e ekspertës lidhur me njohuritë e posaçme që kishte për sa i përket detyrave të dhëna dhe qëndrimin e palëve, ka çmuar se ekspertja ka të gjitha njohuritë e nevojshme lidhur me kryerjen e detyrës dhe përgjigjen e pyetjeve që i janë drejtuar. Sipas subjektit, cilësitë e saj si eksperte kanë ardhur pas vlerësimit të licencave të disponuara prej saj. Ky pretendim është paraqitur edhe në ankimin e ushtruar prej paditësit K. K. në datën 8.4.2015, i cili nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.7.2016, ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 2.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në kushtet kur një prej shkaqeve të ankimit të ushtruar nga denoncuesi ishte edhe fakti i pretenduar në denoncim lidhur me mungesën e licencës përkatëse nga ekspertja, subjekti çmon

se shqyrtimi i këtij pretendimi dhe rrëzimi i tij edhe nga gjykata më e lartë ezauron pretendimin e paraqitur në denoncimin e ushtruar nga ky shtetas.

34.17.2. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetasit K. K. (102 fletë).

34.18. Denoncimi i shtetasit F. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 10.5.2018. Denoncuesi, në cilësinë e paditësit në çështjen civile me palë ndërgjyqëse: trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Q. B. dhe të paditur M. H., me objekt: konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës me nr. ***, datë 30.7.2005 etj., të zgjidhur me vendimin nr. *** akti, datë 25.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe se nuk ka kryer proces të rregullt gjyqësor.

34.18.1. Nga shqyrtimi i denoncimit duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin.

34.19. Denoncimi i shtetasit B. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 28.6.2019, drejtuar 17 subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt: shkelje të rënda ligjore në proces.

34.19.1. Sipas denoncuesit nuk janë marrë për bazë faktet gjatë procesit, duke cenuar të drejtën e tij. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin që lidhet me çështjen objekt konflikti, si dhe vendime gjyqësore të marra nga gjykatat kompetente.

34.19.2. Nga dokumentacioni bashkëlidhur nuk u evidentua ndonjë vendim i marrë nga subjekti në cilësinë e gjyqtarit të vetëm apo anëtar të trupit gjykues.

34.20. Denoncimi i shtetasit A. P., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.7.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryesueses, lidhur me vendimin nr. ***, datë 11.6.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

34.20.1. Denoncuesi ankohet se subjekti ka kryer shkelje procedurale gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, të çështjes me palë ndërgjyqëse: paditës A. G. dhe të paditur vetë denoncuesin, me objekt: përmbushje detyrimi kontraktual. Denoncuesi ka referuar në shkelje të rënda procedurale si: në këtë gjykim gjykata e apelit, me vendimin nr. ***, datë 11.6.2016, nuk ka marrë parasysh kërkesën për riçelje të hetimit gjyqësor. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentacionin⁹ që mbështet denoncimin e tij.

34.20.2. Subjekti ka sqaruar se shkaqet e pretenduara në denoncim nga shtetasi A. P. nuk qëndrojnë.

“Referuar nenit 465 të Kodit të Procedurave Civile, gjykata e apelit, në shqyrtimin e çështjes në apel, mban parasysh për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimin në shkallë të parë, të parashikuara në këtë kod. Me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht, gjykata e apelit përsërit tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimin të shkallës së parë dhe gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja. Në kërkesën e paraqitur nga denoncuesi A. P. lidhur me riçeljen e hetimit gjyqësor, trupi gjykues ka çmuar se nuk ka asnjë prej elementeve të parashikuara në dispozitën e sipërcituar. Nga ana e kërkesit nuk është paraqitur asnjë provë e re e cila do të çonte gjykatën e apelit në detyrimin për të riçelur hetimin gjyqësor, në kushtet kur në kërkesën për riçelje janë parashtruar të njëjtat fakte të paraqitura edhe në kërkesën ankimore dhe në shpjegimet shtesë lidhur me ankimin. Të gjitha

⁹ Kontratë huaje, procesverbale të datave 3.3.2017 dhe 20.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktvlerësimi pasuri të paluajtshme datë 4.5.2017, dhe përmbushje detyrimeve kontraktuale të kontratës datë 31.12.2017, diskutime përfundimtare datë 14.6.2017, vendim nr. ***, datë 16.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ankim datë 30.6.2017, të palës paditëse, vendim nr. ***, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

kërkimet e paraqitura kanë të bëjnë me themelin e gjykimit dhe iu është dhënë përgjigje nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit me vendimin e marrë, por ato nuk përbejnë shkaqe për të pretenduar një hetim të paplotë, ashtu siç edhe është kërkuar nga denoncuesi. Gjukata e apelit ka detyrimin të riçelë hetimin gjyqësor atëherë kur çmon se hetimi i kryer ka qenë jo i plotë apo kur është paraqitur një provë e re e cila ka qenë e pamundur të merrej në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë. Në çështjen objekt denoncimi nuk ndodhemi përpara asnjërit prej këtyre shkaqeve, pasi pretendimet që kanë pasur të bëjnë me themelin e çështjes kanë marrë argumentimin e tyre ligjor në arsyetimin e vendimit, si të gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe të apelit dhe pala kërkuese nuk paraqiti asnjë provë të re e cila do të kishte bërë që trupi gjykues të vlerësonte se duhej të pranohej kërkesa për riçelje të hetimit gjyqësor. Në kushtet kur të gjitha pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë ishin totalisht të njëjta me shpjegimet e dhëna nga denoncuesi në ankim dhe të shtjelluara në mënyrë të hollësishme në seancë gjyqësore, të zhvilluara me argumente e kundërgjyqësore nga të dy palët ndërgjyqësore, çmoj se nuk ka pasur asnjë shkak ligjor për të urdhëruar riçeljen e hetimit gjyqësor nga kjo gjykatë”.

34.20.3. Lidhur me shkaqet e tjera të pretenduara në denoncim i përkasin themelit të gjykimit dhe çmuarjes së provave nga trupi gjykues dhe për këtë denoncuesi ka ushtruar mjetin ligjor të rekursit në Gjykatën e Lartë.

34.21. Denoncimi i shtetases G. M., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.7.2019, drejtuar 9 subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Lidhur me subjektin, denoncuesja ankohet se ka zhvilluar procesin gjyqësor në mungesë të saj dhe për këtë ka bashkëlidhur dokumentacionin përkatës. Komisioni administroi denoncimin dhe e ftoi subjektin të paraqesë shpjegimet lidhur me faktet e referuara.

34.21.1. Subjekti ka shpjeguar se pretendimet e paraqitura në denoncim nuk qëndrojnë. Ndër të tjera, ka sqaruar se kjo shtetase, në kundërshtim me sa argumenton në denoncim, jo vetëm ka qenë prezente personalisht dhe me avokat të zgjedhur, por këto pretendime si lidhur me falsitetin e kërkesëpadisë, ashtu edhe me të drejtën e ngritjes së saj apo të ndërhyrjes kryesore dhe ndërgjyqësisë, i ka paraqitur në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor nëpër të cilat ka kaluar për shqyrtim kjo padi.

34.21.2. Të njëjtat pretendime janë paraqitur si në Gjykatën e Apelit Tiranë, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë dhe nga të dyja këto gjykata nuk janë marrë parasysh, në kushtet kur vendimi i sipërcituar është i formës së prerë. Në këto kushte, për sa kohë që pretendimet në denoncim i referohen zgjidhjes së çështjes në themel dhe ndodhemi përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë, subjekti çmon se argumentet e dhëna në këtë denoncim nuk qëndrojnë dhe nuk kanë bazë ligjore.

34.21.3. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetases H. K. (25 fletë).

34.22. Denoncimi i shtetases A. M., regjistruar me nr. *** prot., datë 16.7.2019, drejtuar disa subjekteve. Kjo shtetase denoncon disa fakte të konstatuara gjatë proceseve ligjore penale të zhvilluara ndaj të vëllait A. M.. Sipas denoncueses, subjektit i rivlerësimit nuk i ka dhënë të drejtën e fjalës gjatë zhvillimit të procesit përfunduar me vendimin nr. ***. Denoncuesja nuk ka bashkëlidhur dokumentacion lidhur me denoncimin.

34.22.1. Subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me çështjen, duke sqaruar se ka qenë relatore dhe kryesuese e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen civile me objekt: lëshim urdhri mbrojtje në ngarkim të saj. Subjekti ka shpjeguar: *“Për sa i përket pretendimit të paraqitur në denoncim, dua t’ju bëj me dije se palës së paditur denoncuese referuar procesverbalit të dy*

seancave gjyqësore i është dhënë jo vetëm e drejta e fjalës lidhur me ankimin e ushtruar dhe çdo veprim procedural të pretenduar e të kryer në seancë, por edhe e drejta e paraqitjes së provave bashkëlidhur ankimit, të cilat sipas saj nuk ishin paraqitur në gjykatën e shkallës së parë. Në këto kushte debati gjyqësor në gjykatën e apelit ka qenë i plotë dhe për sa më sipër, çmoj se pretendimi i paraqitur në denoncim, në kundërshtim edhe me sa reflektohet në procesverbalin e seancës gjyqësore, nuk ka baza provuese dhe nuk duhet të merret në konsideratë nga ana e këtij Komisioni”.

34.22.2. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetases A. M. (170 fletë).

34.23. Denoncimi i shtetases E. J., regjistruar me nr. *** prot., datë 18.7.2019 drejtuar disa subjekteve. Kjo shtetase ka denoncuar se në vendimin e dhënë në datën 14.5.2019, për çështjen me nr. ***, ku subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues, gjykata ka dalë krejtësisht jashtë objektit të padisë, si dhe nuk ka marrë parasysh dokumentacionin e paraqitur nga institucionet kompetente.

34.23.1. Komisioni administroi denoncimin dhe e fton subjektin të paraqesë shpjegimet lidhur me faktet e referuara.

Subjekti ka sqaruar se: *“Referuar shkaqeve të paraqitura në denoncim, dëshiroj t’ju bëj me dije se këto shkaqe i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë çmuarjes së provave të depozituara nga palët ndërgjyqëse, sepse ankuesja të gjitha pretendimet e saj i referon në mënyrën se si trupi gjykues i ka çmuar provat e paraqitura si prej saj, ashtu edhe prej të paditurve, për të përcaktuar pjesët takuese të bashkëpronarëve në sendin në bashkëpronësi në fazën e parë të pjesëtimit. Pavarësisht se vlerësimi i provave lidhur me zgjidhjen e çështjes në themel është e drejtë dhe prerogativë ekskluzive e gjykatës në një proces gjyqësor, theksoj se gjykata e apelit, duke parë kompleksitetin e çështjes objekt gjykimi, në seancën e datës 5.3.2019 ka çmuar në bazë të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile që çështja të kalojë nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi duhet të zhvillohej një debat gjyqësor lidhur me çmuarjen e këtyre provave dhe dëgjimin e ndërgjyqësve në seancë. Pasi çështja ka kaluar në seancë gjyqësore, nga ana e gjykatës së apelit në seancën e datës 7.5.2019 është kryer riçelja e hetimit gjyqësor, duke u vlerësuar edhe një herë të gjitha provat e depozituara nga paditësit dhe të paditurit si në shkallën e parë, ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ka qenë pikërisht shqyrtimi në mënyrë të hollësishme nëpërmjet debatit gjyqësor të këtyre provave që ka çuar gjykatën në kalimin e kësaj çështjeje nga dhoma e këshillimit në seancë publike, pasi në këtë mënyrë debati gjyqësor do të ishte më i plotë dhe pretendimet e palëve do të dëgjoheshin dhe do t’i shërbenin trupit gjykues për të vlerësuar në mënyrë të hollësishme provat e paraqitura. ...*

*... Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin e dhënë prej saj nr. ***, datë 14.5.2019, jo vetëm nuk ka dalë jashtë objektit të padisë, siç edhe është pretenduar nga ankuesja në denoncimin e ushtruar, por ka sqaruar dhe ka ndryshuar pjesët takuese të bashkëpronarëve, duke pranuar pjesërisht ankimet e të gjithë palëve ndërgjyqëse”.*

34.23.2. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetases E. J. (111 fletë).

34.24. Denoncimi i shtetasit S. T., regjistruar me nr. *** prot., datë 27.7.2020, drejtuar disa subjekteve. Ky shtetas nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim.

34.25. Denoncime të shtetases M. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 3.8.2020, nr. ***, datë 21.8.2020, nr. *** prot., datë 29.10.2019, nr. *** prot., datë 4.11.2019 dhe nr. *** prot., datë

4.11.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe dy subjekte të tjerë, me objekt: shkelje nga organet e drejtësisë. Kjo shtetase nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim.

34.26. Denoncime të përsëritura nga shtetasi V. Ç., regjistruar me nr. *** prot., datë 31.7.2019, nr. *** prot., datë 4.10.2019 dhe nr. *** prot., datë 30.10.2019, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

34.26.1. Ky shtetas denoncon se gjykimi është zhvilluar në mungesë të tij – nga administrimi i vendimit nr. ***, datë 7.11.2018, me ankues V. Ç. kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 19.7.2017.

34.26.2. Nga Komisioni, referuar dokumentacionit, u evidentua e shkruar që denoncuesi ka qenë prezent gjatë relativitetit të çështjes, por është larguar vullnetarisht nga salla.

34.27. Denoncimi i shtetasit G. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 13.6.2019, drejtuar subjektit, në cilësinë e gjyqtarës, lidhur me vendimin nr. ***, datë 31.10.2011.

34.27.1. Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka sqaruar se në këtë çështje ka pasur cilësinë e kryesueses së trupit gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor është vendosur rrëzimi i padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 24.5.2012, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit civil nr. ***, datë 31.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.* Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga denoncuesi G. K., duke u paraqitur përsëri të njëjtat pretendime si në ankim.

34.27.2. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 1.10.2014, ka vendosur: *Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga paditësi G. K. kundër vendimit nr. ***, datë 24.5.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe vendimit nr. ***, datë 31.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.* Subjekti ka sqaruar se zgjidhja e çështjes në themel është shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat kanë arritur në të njëjtin konkluzion si subjekti, së bashku me dy kolegët e tjerë në vendim.

Subjekti ka paraqitur faktet dhe rrethanat e çështjes së themelit ku denoncuesi ka qenë palë paditëse, të cilat Komisioni, pas administrimit të tyre, i vlerëson si rrethana të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

34.27.3. Për sa i përket pjesës së denoncimit sipas të cilit ky vendim është dhënë nga subjekti për shkak se paditësi ishte bashkëshorti i një gjyqtareje në të njëjtën gjykatë, subjekti ka sqaruar: *“Dua të ritheksoj se gjatë gjithë viteve të ushtrimit të detyrës si gjyqtare i nënshtrohem vetëm ligjit dhe së drejtës, duke u përpjekur maksimalisht të mos ndikohem nga asnjë rrethanë apo faktor i jashtëm në dhënien e vendimit. Edhe në rastin konkret, vendimi i dhënë nuk ka asnjë lidhje me faktin e pretenduar, pasi gjyqtarja ka qenë kolege që ushtronte të njëjtin funksion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në asnjë rast nuk ka kryer asnjë veprim që të ndikonte në dhënien e këtij vendimi, fakt i cili nëse do të kishte ndodhur do të përbënte veprë penale. Për më tepër që unë në gjykimin e zhvilluar kam qenë pjesë e një trupi gjykues të përbërë nga tre gjyqtare dhe pretendimi se vendimi është dhënë vetëm prej meje si gjyqtare e vetme nuk është i vërtetë dhe nuk përputhet me aktet shkresore që i kam vënë në dispozicion Komisionit”.*

34.27.4. Në përfundim, subjekti ka kërkuar të mos merren parasysh pretendimet nga Komisioni, për sa janë të pavërteta.

34.27.5. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetasit G. K. (151 fletë).

34.28. Denoncimi i shtetasit Gj. A., regjistruar me nr. *** prot., datë 20.7.2018, drejtuar subjektit të rivlerësimit, lidhur me vendimin nr. ***, datë 23.5.2011.

34.28.1. Sipas denoncuesit subjekti ka zhvilluar gjykim ku nuk ka qenë vetë kërkues, në çështjen me objekt: lëshim dëshmie trashëgimie.

34.28.2. Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar se referuar akteve të dosjes gjyqësore (nr. *** vendimi, datë 23.5.2011), rezulton se kërkesa për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë është hartuar nga kërkuesi denoncues Gj. A.. Ajo ka sqaruar duke cilësuar të gjitha datat e seancave gjyqësore, si dhe referuar procesverbalit të seancës gjyqësore datë 23.5.2011, ora 9.30, rezulton se kërkuesi është paraqitur personalisht në gjykim, duke u identifikuar me kartën e tij të identitetit, të shënuar edhe në procesverbal.

34.28.3. Sipas përmbajtjes së kësaj dosjeje nuk rezulton që kërkuesi, edhe pse është paraqitur personalisht në gjykim, të ketë pretenduar se kërkesa nuk është hartuar prej tij apo se është nënshkruar nga ndonjë person tjetër, siç edhe është pretenduar në denoncim. Ka qenë kjo palë që ka paraqitur në gjykim të gjitha certifikatat e vdekjes, familjare dhe personale të trashëgimlënësës O. A, duke bërë të mundur që gjykata, pas administrimit të akteve shkresore, të pranonte kërkesën e paraqitur dhe të çelte dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerën. Në këto kushte, për sa kohë që pala kërkuese ka qenë prezent në gjykim, nuk ka paraqitur asnjë pretendim lidhur me kërkesën e hartuar dhe ka depozituar të gjitha provat shkresore në mbështetje të kërkesës së paraqitur, subjekti ka çmuar se pretendimet e denoncuesit për sa nuk përputhen me asnjë prej akteve shkresore të dosjes gjyqësore, nuk duhet të merren parasysh nga ana Komisioni.

34.29. Denoncimi i shtetasit B. Ç., regjistruar me nr. *** prot., datë 2.8.2018. Ky shtetas ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 5.7.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti ka pasur cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë.

34.30. Denoncime të U. Sh. K. K. "F. I.", regjistruar me nr. ***, datë 16.8.2018 dhe nr. *** prot., datë 19.11.2018, drejtuar një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku subjekti ka pasur cilësinë e anëtares. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim.

34.31. Denoncime të përsëritura të shtetasit Xh. M., regjistruar me nr. *** prot., datë 17.9.2018 dhe nr. *** prot., datë 17.9.2018, drejtuar një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku subjekti ka pasur cilësinë e anëtares.

34.31.1. Denoncuesi ka referuar shkeljet e konstatuara në vendimin nr. ***, datë 23.11.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë se gjykimi është zhvilluar në mungesë të denoncuesit, duke mos e njoftuar dhe se gjykata në vendim ka referuar fakte kontradiktore.

34.31.2. Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar: *"Referuar dosjes gjyqësore dhe faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë, çmoj se palët ndërgjyqëse N. A., Xh. M. dhe përmbaruesi A. S. janë njoftuar për datën dhe orën e seancës gjyqësore të datës 23.11.2017, me shpalljen publike të datës 13.10.2017, ku çështja civile objekt denoncimi mban numrin rendor 5. Referuar nenit 460/3 të Kodit të Procedurës Civile njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes. Në mbështetje të kësaj dispozite gjykata e apelit, në përbërje të së cilës kam qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, pasi ka realizuar njoftimin me shpallje publike për denoncuesin, në kushtet kur as ai dhe asnjë prej palëve ndërgjyqëse nuk është paraqitur në gjykim, ka deklaruar mungesën për paditësin dhe dy të paditurit, duke zhvilluar gjykimin në mungesë të tyre".*

34.31.3. Subjekti ka paraqitur shpjegime edhe për fakte të tjera nga denoncimi që lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes, duke sqaruar: *"Lidhur me themelin e çështjes dhe pretendimin se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës së huas që i padituri ka pasur, çmoj se*

*në rastin konkret pretendimi i palës paditëse lidhur me pavlefshmërinë e kontratës së huas nr. ***, datë 28.8.2010, për shkak se detyrimi nuk ekziston dhe është shuar ndaj huadhënësit M. Sh., nuk është shqyrtuar në themel nga kjo gjykatë, për shkak se ky shtetas nuk ka qenë palë në gjykimin e zhvilluar”.*

34.31.4. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, pjesë nga dosja gjyqësore në ngarkim të shtetasit Xh. M. (34 fletë).

34.32. Denoncimi i shtetasit K. J., regjistruar me nr. *** prot., datë 19.9.2018, me objekt: kundërshtim vendimesh të dhëna nga subjekti i rivlerësimit: vendimi nr. ***, datë 2.2.2007 dhe vendimi për sigurimin e padisë me nr. *** akti, datë 8.12.2005.

34.32.1. Denoncimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë. Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet mbi vendimet e dhëna nga gjykatat, të cilat vlerësohen nga një gjykatë më e lartë, nëpërmjet mjetit ligjor të ankimit.

34.33. Denoncimi i av. A. S., regjistruar me nr. *** prot., datë 1.10.2020, drejtuar një trupi gjykues, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, për shkelje procedurale lidhur me arsyetimin e vendimit datë 17.9.2020, të gjykatës së apelit. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me denoncimin.

34.34. Denoncimi i shtetasit J. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 5.12.2019. Denoncuesi ankohet se ka pasur një çështje gjyqësore me një trup gjykues, ku subjekti ka qenë anëtare. Ky shtetas nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me denoncimin.

34.34.1. Në datën 11.1.2021, pas denoncimit publik të përcjellë nga një media *online* në lidhje me subjektin e rivlerësimit, <http://pamfleti.net/meta-berisha-pazare-per-te-shpjetuar-nga-vetting-gjyqtaren-elbana-lluri-lavatricen-e-tyre-ne-apelin-tiranë-fakte>, trupi gjykues vendosi të verifikojë dosjet gjyqësore mbi çështjet e referuara *online* në artikullin e mësipërm, të shqyrtuara nga subjekti, me palë ndërgjygjëse shoqërinë gjermane “***” dhe çështjen gjyqësore që lidhet me vendimin e lirimt nga burgu të ish-drejtorit të AKBN-së, K. G..

34.35. Lidhur me vendimmarrjen e subjektit për shoqërinë “***”.

34.35.1. Subjekti i rivlerësimit, në datën 22.7.2010, si kryesuese e trupës gjyqësore, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur mbi padinë e themelit si vijon: *“Pranimin pjesërisht të objektit të padisë të paraqitur nga shoqëria “***” sh.p.k., duke konstatuar pavlefshmërinë e: nenit 3.1 të kontratës së nënkoncesionit datë 20.8.2007, lidhur me tarifën koncesionare dhe përfshirjen në të të TVSH-së mbi vlerën e shërbimit të ofruar; nenit 20. 4/9 të kontratës së nënkoncesionit datë 20.8.2007, lidhur me të drejtën e shoqërisë tregtare “***” sh.p.k. për zgjidhjen e kontratës; detyrimin e palëve ndërgjygjëse të zëvendësojnë dispozitat e sipërcituara me dispozita të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që do t’i për afrohen synimit ekonomik dhe qëllimit të kontratës së nënkoncesionit në zbatim të nenit 33.7 të saj dhe licencës nr. ***, datë 6.8.2009; detyrimin e palës së paditur, shoqërinë tregtare “***” sh.p.k. të shpërblejë palën paditëse për dëmin e shkaktuar si rezultat i përfshirjes në tarifën e koncesionit dhe të TVSH-së mbi shërbimin e ofruar në masën 345.466 euro sipas vlerës së përcaktuar në aktin e ekspertimit kontabël; rrëzimin e padisë për paditësen E. Ç. për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv; ligjërimin e masës së sigurimit të padisë caktuar me vendimin nr. *** akti, datë 26.2.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

34.35.2. Ky vendim është ankimuar në gjykatën e apelit, e cila pas shqyrtimit, me vendimin nr. ***, datë 11.3.2011, ka rritur vlerën e dëmshpërblimit ndaj palës së paditur nga 345.466 euro në 801.686 euro dhe kamatëvonesa në shumën 24.869 euro, si dhe vazhdimin e kamatëvonesave deri

në ditën e ekzekutimit të vendimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit është bërë rekurs nga shoqëria tregtare “***” dhe me vendimin nr. 1511, datë 12.10.2011, të Gjykatës së Lartë është vendosur mospranim rekursi.

34.36. Lidhur me vendimin e subjektit për ish-drejtorin e AKBN-së, z. K. G.

34.36.1. Pas kryerjes së hetimeve për një periudhë 3-vjeçare, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të neneve 228, 229, 244 dhe 245 Kodit të Procedurës Penale, i ka kërkuar gjykatës caktimin e masës së sigurimit ndaj personave nën hetim, ndër ta edhe për shtetasin K. G., me arsyetimin se për shkak të rrethanave të faktit dhe sanksionit të parashikuar për veprat penale ekziston rreziku që këta shtetas të largohen, si dhe të vazhdojnë të kryejnë të njëjtën veprimtari të kundërligjshme.

34.36.2. Në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. *** regj., datë 3.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka vendosur në mungesë të personit nën hetim: *Caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim K. G.*

34.36.3. Mbi bazën e ankimit të shtetasit K. G., paraqitur brenda afatit të ankimimit, është investuar gjykata e apelit me kryesuese (relatore) subjektin e rivlerësimit.

34.36.4. Lidhur me verifikimin e kushtit kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që të largohet, është arsyetuar se nuk ka asnjë rrethanë që personi nën hetim t’i shmanget hetimit ose gjykimit të çështjes, pasi është konstatuar se personit nën hetim i është siguruar masa e sigurimit “arrest në burg” pasi është kthyer nga shteti turk ku ka kryer ndërhyrjen kirurgjikale, provuar nga epikriza e lëshuar nga spitali privat “***”, Turqi dhe raporteve të rezultateve të ekzaminimit, sipas të cilave arrihet në përfundimin se largimi i personit ka ndodhur për shkaqe shëndetësore dhe kryerje ndërhyrjeje planifikuar para se të caktohej masa e sigurimit.

34.36.5. Lidhur me verifikimin e rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit nëse ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, është arsyetuar se personi nën hetim ka personalitet të mirë në shoqëri, nuk është përsëritës, nuk i është shmangur hetimit dhe është vetëdorëzuar pas një ndërhyrjeje kirurgjikale.

34.36.6. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me shumicë votash, me vendimin nr. ***, datë 11.11.2020, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 29.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke caktuar si masë sigurimi ndaj personit nën hetim K. G. atë të “arrestit në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Urdhërohet qëndrimi i personit nën hetim në ambientet e banimit në adresën: rruga “***”, godina ***, hyrja ***, ap. *** Tiranë.*

34.36.7. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk u konstatua të jetë bërë rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit lidhur me ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie” për shtetasin K. G..

Qëndrimi i Komisionit

35. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elementë që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që çenojnë figurën e gjyqtares.

35.1. Komisioni vlerëson të theksojë se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë

mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

KONKLuzion Përfundimtar

36. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj.Elbona Lluri:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, nenit 58, germa “a”, e pikës 1 dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbona Lluri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 2.2.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha